



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria Vlada-Government
Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo Ekonomije -Ministry of Economy

DRAFT KONCEPT- DOKUMENTI PËR ENERGJINË TERMIKE

Nëntor, 2024

Përmbajtja:

Përmbledhje e koncept - dokumentit	3
Hyrje.....	8
Kapitulli 1: Përkufizimi i problemit.....	11
1.1. Roli i energjisë termike brenda sistemit energjetik të Kosovës	11
1.2. Konteksti dhe problemet lidhur me energjinë termike	13
1.3. Orientimet strategjike të ndërlidhura me energjinë termike	15
1.4. Dokumentet e politikave, legjislationit dhe institucionet përgjegjëse.....	17
1.5. Aspekte të harmonizimit me bazën ligjore të BE-së	26
1.6. Pema e problemit	31
1.6.1. Problemi kryesor	32
1.6.2. Shkaqet.....	33
1.6.3. Efektet	34
1.7. Krahassimi me vendet e tjera	35
Kapitulli 2: Qëllimi dhe objektivat.....	38
Kapitulli 3: Opsionet.....	41
Opsioni 1- Ruajtja e Status quos (asnjë ndryshim).....	41
Opsioni 2	41
Opsioni 3 – Hartimi i ligjit të ri për energjinë termike.....	42
Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme.....	45
Kapitulli 5: Komunikimi dhe konsultimi.....	51
Kapitulli 6: Krahassimi i opsioneve.....	53
6.1. Tabela e krahasimit me të tre (3) opsionet	54
6.2. Plani i zbatimit për opsionin e rekomanduar	56
Kapitulli 7: Konkluzionet dhe hapat e ardhshëm	59
7.1. Sfidat aktuale, opsioni optimal dhe rezultatet e pritshme.....	59
7.2. Dispozitat për monitorimin dhe vlerësimin.....	59
Shtojca 1: Forma e vlerësimit për ndikimin ekonomik.....	61
Shtojca 2: Forma e vlerësimit për ndikimet shoqërore	65
Shtojca 3: Forma e vlerësimit për ndikimet mjedisore	71
Shtojca 4: Forma e vlerësimit për ndikimin e të drejtave themelore.....	75

Përmbledhje e koncept - dokumentit

Informacionet e përgjithshme	
Titulli	Koncept - Dokumenti për Energjinë Termike
Ministria bartëse	Ministria e Ekonomisë, Departamenti i Energjisë
Personi kontaktues	Rina Kryeziu- Rogova Zyrtare e lartë e sistemeve të ngrohjes dhe gazit natyror Email: rina.kryeziu.rogova@rks-gov.net Numri i telefonit të zyrës 038 200 215 73
Plani Kombëtar për Zhvillim (PKZh)	Plani Kombëtar për Zhvillim për periudhën 2024-2026 , Qëllimi strategjik 2.1- Përmirësimi i sigurisë së furnizimit me energji, qëndrueshmërisë dhe përballueshmërisë, Masa strategjike 2.1.6- <i>Përmirësimi i kornizave të politikave dhe legjislacionit.</i>
Prioriteti strategjik	1. Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës për periudhën 2022-2031¹ <u>Objektivi Strategjik 2-</u> Dekarbonizimi dhe promovimi i energjisë së ripërtëritshme Objektivi specifik 2.3- Promovimi i përdorimit të qëndrueshëm të energjisë së ripërtëritshme për ngrohje: • Promovimi i sistemeve më efikase dhe më të pastra për ngrohje individuale dhe/ose qendrore duke marrë parasysh BRE-të (p.sh. biomasën, ngrohjen gjeotermike dhe pompat termike; • Diversifikimi i teknologjisë të sistemit ekzistues të Ngrohjes Qendrore (NQ) të Prishtinës deri në vitin 2025, në mënyrë që të përfshihet ngrohja solare prej së paku 50 MW_{th}. <u>Objektivi Strategjik 3-</u> Rritja e Eficiencës së Energjisë (EE) Objektivi specifik 3.1- Përmirësimi i Eficiencës së Energjisë (EE) në ndërtesa: • Përkrahja e teknologjive energji-efikase dhe miqësore ndaj mjedisit siç janë pompat termike dhe sistemet solar termike; Objektivi specifik 3.2 Promovimi i kogjenerimit efikas dhe sistemeve efikase të Ngrohjes Qendrore (NQ): • Promovimi i sistemeve efikase të Ngrohjes Qendrore (NQ) nëpërmjet dyfishimit të kapacitetit ekzistues të kogjenerimit.

¹ <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/03/Strategjia-e-Energjisë-e-Republikës-së-Kosovës-2022-2031.pdf>

	2. Programi për Zbatimin e Strategjisë së Energjisë së Kosovës (PZSEK) për periudhën 2022-2025² Pika III.2- Objektivet specifik: Promovimi i kogjenerimit efikas the sistemeve eficiente të Ngrohjes Qendrore (NQ). Pika III.2.3- Veprimi: <i>Dyfishimi i kapacitetit të kogjenerimit dhe zgjerimi i rrjetit të transmisionit të ndërmarrjeve Termokos/KEK deri në vitin 2025.</i> 3. Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për periudhën 2021-2025³ Pika 2.14.1-Krijimi i kushteve për furnizim të qëndrueshëm me energji. 4. Agjenda e reformave evropiane (ERA II)⁴ Prioriteti 2.2: <i>Angazhimi drejt përmbushjes së caqeve të Eficiencës së Energjisë (EE) dhe energjisë së ripërtëritshme.</i> 5. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2025-2027⁵ Prioriteti 2 (sektori Energjia): Rritja e pjesëmarrjes së burimeve të ripërtëritshme në miksin energjetik, Drejtimi/orientimi kryesor për zbatim 2.2: <i>Promovimi i përdorimit të energjisë së ripërtëritshme për ngrohje.</i>
--	--

Vendimi	
Çështja kryesore	Furnizimi me energji në Republikën e Kosovës, vazhdon të dominohet nga linjiti si lëndë djegëse fosile, djegia e të cilit rezulton në ndotje të madhe të mjedisit. Për më tepër, kapacitetet ekzistuese të prodhimit të energjisë elektrike bazohen në Termocentrale me teknologji të vjetruar, e cila ka nevojë për mirëmbajtje të rregullt dhe të kushtueshme. Një faktor rëndues në këtë aspekt rezulton nga sektori i ngrohjes ku një pjesë e madhe e ndërtesave rezidenciale shfrytëzojnë energjinë elektrike për ngrohje. Gjendja e tillë reflektohet negativisht, si në aspektin ekonomik të vet ekonomive familjare për shkak të kostos dukshëm më të lartë të ngrohjes me energji elektrike, por po ashtu edhe në rritjen e konsiderueshme të konsumit të energjisë elektrike në periudhën e dimrit. Paraqitja e fyteve të ngushta në sektorin e furnizimit dhe të prodhimit të energjisë elektrike, si rezultat i gjendjes së tillë, ka ndikim domethënës negativ në rentabilitetin e entiteteve prodhuese, ndërmarrjeve komerciale, sektorin e shërbimeve dhe në fushat tjera ekonomike. Rrjedhimisht, vazhdimi i situatës së tillë pashmangshëm do të përcillet me pasoja afatgjate ekonomike si rezultat i rëndimit të buxhetit të amvisërive, zvogëlimit të mundësisë së zhvillimit të ndërmarrjeve, dhe kufizimit të mundësisë së krijimit të vendeve të reja të punës. Në anën tjetër, realizimi me sukses i projektit të kogjenerimit të energjisë termike dhe asaj elektrike në Termocentralin “Kosova B”, duke shfrytëzuar rrjetin e Termokosit, ka treguar që kjo formë e prodhimit të ngrohjes mund të jetë shumë e

² https://me.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/10/PZSEK-2022-2025_SHQ.pdf

³ <https://masht.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/06/Programi-i-Qeverisë-së-Kosovës-2021-2025.pdf>

⁴ <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/05/1-PV-ERA-II-miraturar-nga-Kuvendi.pdf>

⁵ <https://kk.rks-gov.net/vushtrri/wp-content/uploads/sites/33/2024/07/KASH-2025-2027.pdf>

	dobishme në stabilizimin e furnizimit me energji termike e rrjedhimisht edhe të furnizimit me energji elektrike. Përvoja e tillë është reflektuar edhe në planifikimin e kapaciteteve të reja kogjeneruese, diverifikimin e burimeve energjetike që mund të përdoren për nevoja të Ngrohjes Qendrore (NQ), si dhe në shtrirjen e rrjetit nëpër komuna tjera. Megjithatë, planifikimet e tilla nuk janë përcjellë me përditësimin e bazës ligjore e cila do të ishte në funksion të realizimit të objektivave përkatëse strategjike lidhur me energjinë termike. Me qëllim të tejkalimit të kësaj gjendje është iniciuar hartimi i koncept- dokumentit aktual, në mënyrë që të jepet një pasqyrë e detajuar e të gjitha problemeve, sfidave, shkaqeve dhe pasojave nëse nuk ka ndryshim të gjendjes. Bazuar në analizën e koncept - dokumentit, përvojat e vendeve tjera, diskutimet brenda Grupit Punues (GP) dhe konsultimet me akterët tjerë relevant, Grupit Punues (GP) i ka rekomanduar opsionin i cili do të mundësonte që të hartohej baza ligjore gjithëpërfshirëse, në linjë me direktivat e BE-së, në funksion të promovimit të përfshirjes së formave alternative të prodhimit të energjisë, zgjerimit të kapaciteteve, promovimit të konkurrencës, cilësisë së shërbimeve, mbështetjes së bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve qendrore dhe atyre lokale, planifikimit me kohë dhe sipas standardeve të ngrohjes së ujit sanitar nëpërmjet rrjetit të Ngrohjes Qendrore (NQ), adresimit meritot të paqartësive lidhur me koston e operimit dhe mirëmbajtjen e rrjetit sekondar, si dhe përfshirjes së dispozitave përkatëse me karakter parandalues të abuzimeve dhe lëshimeve eventuale nga palët.
Përmbledhje e konsultimeve	Plotësohet pas procesit të konsultimeve paraprake dhe publike.
Opsioni i propozuar	Të hartohet ligj i ri për energjinë termike me qëllim të adresimit të sfidave aktuale, përmirësimit të efijencës së energjisë termike, mbështetjes së përdorimit të burimeve të ripërtëritshme dhe integritit të teknologjive e reja, në përputhje me legjislacionin e BE-së, dhe në funksion të sigurimit të furnizimit të qëndrueshëm me energji termike.

Ndikimet kryesore të pritshme	
Ndikimet buxhetore	Opsionet e shqyrtuara mbulohen nga buxheti i Republikës së Kosovës, si dhe përkrahja e donatorëve.
Ndikimet ekonomike	- Nxiten investimet e brendshme dhe të huaja në sektorin e diversifikimit të burimeve energjetike të përdorura për ngrohje; - Diversifikimi i burimeve për ngrohje në rend të parë nëpërmjet rritjes së pjesëmarrjes së Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë (BRE) dhe nëpërmjet

	aplikimit të teknologjive të avancuara siç janë: pompat termike reflektohen jo vetëm në uljen e ndikimeve negative mjedisore por edhe në uljen e kostos së furnizimit me energji termike dhe rritjen e sigurisë së furnizimit me energji; • Ulja e kostos për energji termike dhe përmirësimi i furnizimit me energji, kanë ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e bizneseve dhe krijimin e vendeve të reja të punës në sektorin e prodhimit, instalimit, mirëmbajtjes dhe servisimit.
Ndikimet shoqërore	• Krijimi i sistemit të qëndrueshëm të furnizimit me energji termike zvogëlon varfërinë energjetike të popullatës; • Rritja e punësimit reflektohet në përgjithësi në rritjen e mirëqenies së popullsisë; • Stabiliteti i furnizimit me energji termike ka ndikim të drejtpërdrejtë në komforin e jetës, të punës dhe arsimimit të qytetarëve; • Diversifikimi i burimeve për furnizim me energji termike reflektohet në furnizim stabil dhe çmime të balancuara të energjisë; • Shfrytëzimi i burimeve energjetike miqësore ndaj mjedisit siç janë: Burimet e Ripërtërishme të Energjisë (BRE), për nevoja të furnizimit me energji termike, ndikon në rritjen e vetëdijes së qytetarëve për rëndësinë e shfrytëzimit racional të burimeve energjetike; • Zvogëlimi i ndotjes mjedisore si rezultat i aplikimit të burimeve të ripërtërishme për ngrohje, reflektohet drejtpërdrejtë në përmirësimin shëndetit të qytetarëve.
Ndikimet mjedisore	• Përdorimi i burimeve të ripërtërishme dhe teknologjive moderne për sigurimin e energjisë termike ulë ndjeshëm ndotjen e mjedisit; • Nëpërmjet zvogëlimit të emetimeve të CO₂ dhe gazrave tjerë serrë, vendi shënon progres drejt përmbushjes së obligimeve karshi Traktatit të Komitetit të Energjisë (TKE), lidhur me zbutjen e ndryshimeve klimatike.
Ndikimet ndërsektoriale	• Investimet në sektorin e energjisë termike janë të ndërlidhura me rritjen e sektorit të industrisë, zvogëlimin e papunësisë por edhe me rritjen e nevojës për trajnimin dhe kualifikimin e të rinjve në fushën e teknologjisë së energjisë termike dhe Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë (BRE); • Ndikimet tjera janë të ndërlidhura me zhvillimet infrastrukturore dhe planifikimet urbanistike.
Ngarkesat administrative për kompanitë	Mund të paraqiten ngarkesat si vijon: • Ngarkesat administrative lidhur me licencimin e aktiviteteve të ndryshme tek Rregullatori; • Ngarkesat për ngritjen e kapaciteteve administrative në funksion të monitorimit dhe raportimit lidhur me zbatimin e ligjit të ri; • Ngarkesat lidhur me ngritjen e kapaciteteve administrative në funksion të matjes, faturimit dhe informimit të konsumatorëve.
Testi i NVM-ve	Përmirësimi dhe zgjerimi i mundësive të furnizimit me energji termike reflektohet pozitivisht në sektorin e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM). Kjo për faktin që furnizimi i qëndrueshëm dhe me çmime konkurruese me energji termike,

	krijon stabilitet financiar për ndërmarrjet dhe kushte më të mira të punës. Zhvillimet e tilla krijojnë mundësinë për investime të reja dhe në këtë mënyrë reflektohen në rritjen e prodhimit dhe përmirësimin e shërbimeve që ofrohen nga ndërmarrjet përkatëse.
--	---

Hapat e ardhshëm	
Afatshkurtër	Pas miratimit të këtij koncept - dokumenti nga Qeveria e Republikës së Kosovës (QRK), një grup i ri pune do të krijohet nga Ministria e Ekonomisë (ME), në bashkëpunim me të gjitha palët e interesit, për të filluar punën për zbatimin e opsionit të rekomanduar të këtij koncept - dokumenti, hartimin ligjit të ri për energjinë termike.
Afatmesëm	Pas miratimit të koncept - dokumentit dhe pastaj hartimit dhe miratimit të ligjit të ri për energjinë termike, do të organizohen takime, debate publike dhe punëtori për të promovuar ligjin e ri me qëllim të njoftimit të institucioneve të nivelit qendror dhe lokal për mënyrën e zbatimit të tij. Paralelisht me këtë, Ministria e Ekonomisë (ME), në bashkëpunim me akterët tjerë të sektorit, do të fillojnë me hartimin, plotësimin, dhe nxjerrjen e legjislacionit sekondar të nevojshëm për zbatimin e ligjit të ri për energjinë termike. Hartimi i legjislacionit të ri për energjinë termike, përfshirë aktivitetet e caktuara në kuadër të ligjit për energjinë termike, synohet të finalizohet më së largu deri në fund të vitit 2026. Pas miratimit në Kuvendin e Kosovës që planifikohet se do të realizohet deri në fund të vitit 2026, do të pason procesi i hartimit dhe miratimit të legjislacionit sekondar i cili planifikohet të kryhet deri në mesin e vitit 2027.

Hyrje

Sektori i energjisë termike në Republikën e Kosovës përballët me një mori sfidash që kanë të bëjnë me mangësitë e trajtimit ligjor të problemeve të funksionimit praktik, dhe mungesën e dispozitave që do të mbështesin realizimin e planeve për zhvillimin domethënës që parashihet të ndodhë këtë fushë. Ligji aktual për energjinë termike nuk është përditësuar për të pasqyruar avancimet dhe nevojat e dekadës së fundit dhe kjo ka bërë që aktualisht të ekzistoj një mospërputhje ndërmjet kërkesave të sektorit dhe kornizës ligjore përkatëse. Në këtë kontekst, dokumenti aktual do të analizoj dhe trajtoj në mënyrë të detajuar aspektet për adresimin e të cilave ligji aktual nuk ofron kornizën e nevojshme ligjore, disa prej të cilave janë prezantuar më poshtë në kuadër të kësaj hyrje, dhe nëpërmjet formulimit gjithëpërfshirës të tërë problemit aktual, si dhe diskutimit të shkaqeve dhe pasojave ku do të shtjellohen opsionet e mundshme dhe të identifikohet opsioni përkatës i cili rekomandohet të ndiqet nga institucionet. Për më tepër, opsioni i cili do të rekomandohet përveç që do të shërbej për adresimin e sfidave të prezantuara në vijim, do të shërbej edhe për transpozimin e plotë të disa aspekteve relevante të kornizës ligjore të BE-së, siç janë: p.sh. mënyra e përcaktimit të kostos së ngrohjes dhe ftohjes të ndërtesat shumëbanesore ose ndërtesat me destinacion të shumëfishtë, afatet lidhur me njehsorët inteligjent dhe nevojën e specifikimit të sasive minimale të energjisë nga BRE-të, brenda kodeve të ndërtimit.

Për shkak të nevojës për furnizim më të mirë dhe stabil me energji, në dekadën e fundit ka pas një progres në stabilizimin e furnizimit me energji termike të bazuar në bashkëprodhim me energjinë elektrike nga Termocentrali “Kosova B” ndërkohë që janë planifikuar kapacitete të reja, zgjerimi i rrjetit dhe shfrytëzimi i Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë (BRE), për nevoja të energjisë termike.

Megjithatë korniza ekzistuese ligjore është e pamjaftueshme për ofrimin e kuadrit të nevojshëm ligjor i cili do të shërbente për promovimin e ndërtimit të kapaciteteve të reja të bashkëprodhimit të energjisë nëpër komunat Republikës së Kosovës, përfshirjen më aktive të autoriteteve komunale në zhvillimet e tilla, promovimin e konkurrencës me qëllim të përmirësimit të shërbimeve dhe sigurimit të kostos reale dhe stabile për shërbimin e ofruar, rregullimin adekuat të mënyrës së qasjes në prona publike dhe private për nevoja të shtrirjes së rrjetit, adresimin e mënyrës së mbulimit me energji termike të hapësirave të përbashkëta, adresimin e përgjegjësisë për mirëmbajtje dhe operim të rrjetit përkatës, si dhe sqarimin e situatave kontestuese me qëllim të parandalimit të kontesteve gjyqësore. Po ashtu, si rezultat i transpozimit jo të plotë të dispozitave relevante nga korniza ligjore e BE-së, baza aktuale ligjore nuk përkon me obligimet e Republikës së Kosovës në raport me Komunitetin e Energjisë (KE) dhe me zotimet në kuadër të Deklaratës së Sofjes, lidhur me përmirësimin e Eficiencës së Energjisë (EE), në sektorin e ngrohjes dhe përfshirjen e formave alternative të prodhimit të energjisë në funksion të tranzicionit energjetik dhe zvogëlimit të ndotjes mjedisore.

Rrjedhimisht, krahas përditësimit të një pjese të legjislacionit që mbulon segmente të ndryshme të energjisë, është iniciuar edhe hartimi i këtij koncept - dokumenti, me qëllim të analizimit të detajuar të gjendjes, vlerësimit të alternativave dhe nxjerrjes së rekomandimeve përkatëse për institucionet me qëllim të krijimit të një baze ligjore moderne, në harmoni me nevojat e vendit dhe në linjë me politikat e BE-së në fushën e energjisë termike.

Tabela 1: Tabela me informacione të përgjithshme për koncept - dokumentin

Titulli	Koncept Dokumenti për Energjinë Termike
Ministria bartëse	Ministria e Ekonomisë, Departamenti i Energjisë Divizioni për hartimin e politikave të energjisë
Personi kontaktues	Rina Kryeziu- Rogova Zyrtare e lartë e sistemeve të ngrohjes dhe gazit natyror Email: rina.kryeziu.rogova@rks-gov.net Numri i telefonit të zyrës 038 200 215 73
PKZh	Plani Kombëtar për Zhvillim për periudhën 2024-2026 , Qëllimi strategjik 2.1- Përmirësimi i sigurisë së furnizimit me energji, qëndrueshmërisë dhe përballueshmërisë, Masa strategjike 2.1.6- <i>Përmirësimi i kornizave të politikave dhe legjislacionit.</i>
Prioriteti strategjik	1. Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës për periudhën 2022-2031 <u>Objektivi Strategjik 2-</u> Dekarbonizimi dhe promovimi i energjisë së ripërtëritshme Objektivi specifik 2.3- Promovimi i përdorimit të qëndrueshëm të energjisë së ripërtëritshme për ngrohje: • Promovimi i sistemeve më efikase dhe më të pastra për ngrohje individuale dhe/ose qendrore duke marrë parasysh BRE-të (p.sh. biomasën, ngrohjen gjeotermike dhe pompat termike); • Diversifikimi i teknologjisë të sistemit ekzistues të Ngrohjes Qendrore (NQ) të Prishtinës deri në vitin 2025, në mënyrë që të përfshihet ngrohja solare prej së paku 50 MW_{th}. <u>Objektivi Strategjik 3-</u> Rritja e Eficiencës së Energjisë (EE) Objektivi specifik 3.1- Përmirësimi i Eficiencës së Energjisë (EE) në ndërtesa: • Përkrahja e teknologjive energji-efikase dhe miqësore ndaj mjedisit siç janë: pompat termike dhe sistemet solar termike. Objektivi specifik 3.2 Promovimi i kogjenerimit efikas dhe sistemeve efikase të Ngrohjes Qendrore (NQ): • Promovimi i sistemeve efikase të Ngrohjes Qendrore (NQ) nëpërmjet dyfishimit të kapacitetit ekzistues të kogjenerimit. 2. Programi për Zbatimin e Strategjisë së Energjisë së Kosovës (PZSEK) për periudhën 2022-2025 Pika III.2- Objektivet specifik: Promovimi i kogjenerimit efikas the sistemeve efikase të Ngrohjes Qendrore (NQ) Pika III.2.3- Veprimi: Dyfishimi i kapacitetit të kogjenerimit dhe zgjerimi i rrjetit të transmissioinit të ndërmarrjeve Termokos/KEK deri në vitin 2025.

	3. Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për periudhën 2021-2025 Pika 2.14.1-Krijimi i kushteve për furnizim të qëndrueshëm me energji. 4. Agjenda e reformave evropiane (ERA II) Prioriteti 2.2: <i>Angazhimi drejt përmbytjes së caqeve të Eficiencës së Energjisë (EE) dhe energjisë së ripërtëritshme.</i> 5. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve për periudhën 2025-2027 Prioriteti 2 (sektori Energjia): Rritja e pjesëmarrjes së burimeve të ripërtëritshme në miksin energjetik, Drejtimi/orientimi kryesor për zbatim 2.2: <i>Promovimi i përdorimit të energjisë së ripërtëritshme për ngrohje.</i>																																																																												
Grupi Punues (GP)	Anëtarët e Grupit Punues (GP) sipas Vendimit Nr. 5091, më datë:11 korrik 2024 <table><tr><td>1.</td><td>Rina Kryeziu- Rogova</td><td>DE/ME</td><td>Kryesuese</td></tr><tr><td>2.</td><td>Miftar Nika</td><td>DE/ME</td><td>Anëtar</td></tr><tr><td>3.</td><td>Deniza Krasniqi</td><td>DL/ME</td><td>Anëtare</td></tr><tr><td>4.</td><td>Mendohije Kabashi</td><td>DIEKP/ME</td><td>Anëtare</td></tr><tr><td>5.</td><td>Behije Tahiri</td><td>DBF/ME</td><td>Anëtare</td></tr><tr><td>6.</td><td>Bekim Brahimi</td><td>NJIE/ME</td><td>Anëtare</td></tr><tr><td>7.</td><td>Fahrije Qorraj</td><td>NJMBNJ</td><td>Anëtare</td></tr><tr><td>8.</td><td>Egzona Raçi</td><td>SKQ/ZKM</td><td>Anëtare</td></tr><tr><td>9.</td><td>Jehona Ademi</td><td>MFPT</td><td>Anëtare</td></tr><tr><td>10.</td><td>Arben Ajazi</td><td>MMPHI</td><td>Anëtar</td></tr><tr><td>11.</td><td>Blerim Halabaku</td><td>MINT</td><td>Anëtar</td></tr><tr><td>12.</td><td>Arsim Osmani</td><td>AKK</td><td>Anëtar</td></tr><tr><td>13.</td><td>Dr. Drilon Meha</td><td>UP/FIM</td><td>Anëtar</td></tr><tr><td>14.</td><td>Bajram Seferaj</td><td>MBPZhR</td><td>Anëtar</td></tr><tr><td>15.</td><td>Besim Myrtezani</td><td>MAPL</td><td>Anëtar</td></tr><tr><td>16.</td><td>Astrit Saraqini</td><td>ZRrE</td><td>Anëtar</td></tr><tr><td>17.</td><td>Përparim Kabashi</td><td>KEK</td><td>Anëtar</td></tr><tr><td>18.</td><td>Valdete Marevci</td><td>Termokos</td><td>Anëtare</td></tr><tr><td>19.</td><td>Florentina Lamaj</td><td>Ngrohtorja Gjakovë</td><td>Anëtare</td></tr></table>	1.	Rina Kryeziu- Rogova	DE/ME	Kryesuese	2.	Miftar Nika	DE/ME	Anëtar	3.	Deniza Krasniqi	DL/ME	Anëtare	4.	Mendohije Kabashi	DIEKP/ME	Anëtare	5.	Behije Tahiri	DBF/ME	Anëtare	6.	Bekim Brahimi	NJIE/ME	Anëtare	7.	Fahrije Qorraj	NJMBNJ	Anëtare	8.	Egzona Raçi	SKQ/ZKM	Anëtare	9.	Jehona Ademi	MFPT	Anëtare	10.	Arben Ajazi	MMPHI	Anëtar	11.	Blerim Halabaku	MINT	Anëtar	12.	Arsim Osmani	AKK	Anëtar	13.	Dr. Drilon Meha	UP/FIM	Anëtar	14.	Bajram Seferaj	MBPZhR	Anëtar	15.	Besim Myrtezani	MAPL	Anëtar	16.	Astrit Saraqini	ZRrE	Anëtar	17.	Përparim Kabashi	KEK	Anëtar	18.	Valdete Marevci	Termokos	Anëtare	19.	Florentina Lamaj	Ngrohtorja Gjakovë	Anëtare
1.	Rina Kryeziu- Rogova	DE/ME	Kryesuese																																																																										
2.	Miftar Nika	DE/ME	Anëtar																																																																										
3.	Deniza Krasniqi	DL/ME	Anëtare																																																																										
4.	Mendohije Kabashi	DIEKP/ME	Anëtare																																																																										
5.	Behije Tahiri	DBF/ME	Anëtare																																																																										
6.	Bekim Brahimi	NJIE/ME	Anëtare																																																																										
7.	Fahrije Qorraj	NJMBNJ	Anëtare																																																																										
8.	Egzona Raçi	SKQ/ZKM	Anëtare																																																																										
9.	Jehona Ademi	MFPT	Anëtare																																																																										
10.	Arben Ajazi	MMPHI	Anëtar																																																																										
11.	Blerim Halabaku	MINT	Anëtar																																																																										
12.	Arsim Osmani	AKK	Anëtar																																																																										
13.	Dr. Drilon Meha	UP/FIM	Anëtar																																																																										
14.	Bajram Seferaj	MBPZhR	Anëtar																																																																										
15.	Besim Myrtezani	MAPL	Anëtar																																																																										
16.	Astrit Saraqini	ZRrE	Anëtar																																																																										
17.	Përparim Kabashi	KEK	Anëtar																																																																										
18.	Valdete Marevci	Termokos	Anëtare																																																																										
19.	Florentina Lamaj	Ngrohtorja Gjakovë	Anëtare																																																																										
Informata shitesë	Hartimi i këtij koncept - dokumenti rrjedh nga obligimet e Republikës së Kosovës si palë nënshkruese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë ⁶ (TKE), dhe nevoja për të përditësuar kornizën ligjore lidhur me energjinë termike.																																																																												

⁶ [https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:22006A0720\(01\)](https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:22006A0720(01))

Kapitulli 1: Përkufizimi i problemit

1.1. Roli i energjisë termike brenda sistemit energjetik të Kosovës

Energjia termike mund të interpretohet si një formë e energjisë e prodhuar në stabilimentet termoenergjetike dhe e bartur deri te shfrytëzuesi i caktuar zakonisht me anë të ujit ose avullit, me qëllim të plotësimit të nevojave për ngrohje të hapësirave ose të ujit sanitar, respektivisht e bartur nëpërmjet ujit të ftohur me qëllim të plotësimit të nevojave për ftohje të hapësirave. Lidhur me dokumentin aktual, energjia termike paraqet energjinë e prodhuar nga gjeneratorët e avullit nëpërmjet djegies së linjtit ose në kaldaja përkatëse nëpërmjet djegies së mazutit, e cila energji termike transmetohet në ujë e i cili pastaj si ujë që përmban energji termike shërben për ngrohjen e ndërtesave. Një formë e tillë e interpretimit të energjisë termike haset kryesisht brenda akteve ligjore të cilat trajtojnë energjinë termike që prodhohet në kuadër të sistemeve të ngrohjes/ftohjes qendrore të njohura ndryshe edhe si sisteme të ngrohjes/ftohjes nga largësia. Mirëpo formë e energjisë termike është edhe energjia e cila prodhohet nga pajisjet vetjake brenda objekteve hapësirat e të cilave kanë nevojë të ngrohen/ftohen respektivisht të cilat kanë nevojë për ujë të ngrohtë sanitar. Po ashtu duhet pasur parasysh që energjia termike lehtësisht mund të fitohet edhe si rezultati i konvertimit të energjisë elektrike në pajisjet përkatëse elektrike për ngrohje dhe/ose ftohje, gjë që shpeshherë ndodhë në praktikë.

Nga ajo që u tha është e qartë që si koncept energjia termike është e ndërlidhur në mënyrë komplekse me aspekte tjera vendimtare për mirëfunksionimin e sistemit energjetik të vendit siç janë: Eficienca e Energjisë (EE), Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë (BRE), përzierja e burimeve energjetike për prodhimin e energjisë elektrike, por edhe me elemente tjera që karakterizojnë zhvillimin e qëndrueshëm energjetik siç është p.sh. mundësia e rikthimit (rishfrytëzimit) të energjisë së humbur termike. Rrjedhimisht, një rol domethënës në përmirësimin e Eficiencës së Energjisë (EE) të një vendi luajnë pajisjet përkatëse të cilat mundësojnë prodhimin eficient të energjisë termike, si dhe pajisjet të cilat karakterizohen me eficiencë të lartë të shfrytëzimit të kësaj forme të energjisë për nevoja të ngrohjes dhe ftohjes. Nëse merret në konsideratë që një pjesë e madhe e energjisë termike në Kosovë gjenerohet nëpërmjet energjisë elektrike ndërsa rreth nëntëdhjetë e gjashtë për qind (96 %) e saj gjenerohet nga linjiti, mund të nxirret përfundimi për rëndësinë domethënëse që ka adresimi adekuat i prodhimit dhe shfrytëzimit të energjisë termike për furnizimin e qëndrueshëm me energji elektrike dhe për zvogëlimin e ndotjes së mjedisit. Në anën tjetër, në raport me format tjera të shfrytëzimit të energjisë, energjia termike është ndër format më të kërkuara, meqë rreth dyzet për qind (40 %) e energjisë totale të konsumuar në Kosovë shfrytëzohet për nevoja të sektorit rezidencial e në këtë total energjia termike për nevoja të ngrohjes merr pjesë me gjashtëdhjetë e gjashtë për qind (66 %⁷). Një situatë

⁷ WBC-INCO.NET (2013): Priority Setting to Structure Participation on the 7th Framework program, Background Country Report- Kosovo, Chapter Energy (s.237), <https://kec-ks.org/wp-content/uploads/2016/05/National-Reports.pdf>

e ngjashme raportohet edhe në nivel të vendeve të BE-së^{8,9}. Prandaj, për adresimin e mirëfilltë dhe gjithëpërfshirës të energjisë termike është e paevitueshme nevoja për trajtimin e kësaj forme të energjisë në kuadër të kontekstit më të gjerë e i cili merr në konsideratë të gjitha aspektet relevante për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të qëndrueshëm të furnizimit me energji të llojeve dhe sasive të cilat imponohen nga kërkesa.

Në ndër momentet vendimtare në historinë e ngritjes së sistemit energjetik të Republikës së Kosovës padyshim është i ndërlidhur me anëtarësimin e saj në Komunitetin e Energjisë (KE) nëpërmjet nënshkrimit të traktatit të këtij komuniteti në vitin 2005¹⁰. Angazhimi i institucioneve të vendit për plotësimin e obligimeve në raport me Komunitetin e Energjisë (KE), por edhe nevoja reale për tejkalimin e problemeve praktike të furnizimit të qytetarëve dhe ekonomisë së vendit me energji, ka rezultuar në konsolidim domethënës të institucioneve relevante për trajtimin e energjisë dhe në një kornizë solide strategjike dhe ligjore. Në këtë kuadër të Republikës së Kosovës është e angazhuar plotësisht në hartimin e dokumenteve strategjike në funksion të ndërtimit të sistemit stabil energjetik dhe në linjë me përpjekjet e BE-së, për realizimin e tranzicionit energjetik deri në vitin 2050. Angazhimet e tilla kanë rezultuar po ashtu në transpozimin e direktivave relevante të BE-së, në sektorin e energjisë, në hartimin dhe zbatimin e planeve të veprimit në raport me përmirësimin e Efiçencës së Energjisë (EE) dhe rritjes së pjesëmarrjes së BRE-ve, në përzierjen aktuale energjetike, si dhe në ngritjen e infrastrukturës institucionale. Angazhimet e tilla janë në vijë plotë me atë që njihet botërisht se ofrimi i shërbimeve adekuate dhe të qëndrueshme energjetike është parakusht për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Në rastin e Republikës së Kosovës përafrimi i bazës ligjore në fushën e energjisë me atë të BE-së, ka ndikuar në investime domethënëse në sektorin e BRE-ve, konkretisht në ngritjen e kapaciteteve të reja që bazohen në energjinë e erës dhe atë të diellit. Një progres domethënës është shënuar po ashtu në rritjen e investimeve në fushë të Efiçencës së Energjisë (EE), kryesisht si investime për përmirësimin e Efiçencës së Energjisë (EE), në ndërtesat e sektorit publik, ndërsa viteve të fundit në kuadër të masave të mbështetura nga Fondi i Kosovës për Efiçencë të Energjisë (FKEE), është shënuar progres edhe në mbështetjen financiare të sektorit rezidencial. Investimet e tilla natyrisht janë përcjellë me hapjen e vendeve të reja të punës, qëndrueshmërinë e ndërmarrjeve përkatëse, themelimin e bizneseve të reja dhe në përgjithësi në krijimin e një fushe vibrante ekonomike. Natyrisht, investimet në fushën e BRE-ve dhe Efiçencë të Energjisë (EE), janë përcjellë me progres relevant edhe në fushën e mjedisit, meqë masat e tilla në Republikën e Kosovës reflektohen drejtpërdrejtë në uljen e varësisë së furnizimit me energji nëpërmjet djegies së linjtit. Rrjedhimisht, masat e tilla kanë rezultuar në uljen e emetimeve të Gazeve Serrë (GS), dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit e në këtë mënyrë kanë pasur ndikim pozitiv edhe në shëndetin publik.

⁸ https://energy.ec.europa.eu/topics/energy-efficiency/energy-efficient-buildings/energy-performance-buildings-directive_en

⁹ https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?title=Energy_consumption_in_households

¹⁰ <https://me.rks-gov.net/traktati-per-themelimin-e-komunitetit-te-energjise/>

Një zhvillim tjetër, po ashtu vendimtar për progresin e përgjithshëm të Republikës së Kosovës në rrugën e integritimit evropian e në këtë aspekt edhe në sektorin e energjisë është shënuar me ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit në vitin 2015 me ç'rast nga Republika e Kosovës janë marrë, përveç tjerash, obligime edhe për transpozimin e direktivave të BE-së, në fushën e energjisë siç janë ato që kanë të bëjnë me Eficiencën e Energjisë (EE), Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë (BRE), dhe performancën e energjisë në ndërtesa.

Moment tjetër me rëndësi në angazhimin e Republikës së Kosovës në funksion të mbështetjes së politikave të BE-së, në raport me nevojat energjetike dhe mjedisore, është shënuar së fundmi me nënshkrimin e Deklaratës së Sofjes lidhur me Agjendën e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor në vitin 2020¹¹. Nëpërmjet nënshkrimit të kësaj deklarate, Kosova si edhe vendet tjera të Ballkanit Perëndimor (BP) janë zotuar të bëhen pjesë e përpjekjeve të Bashkimit Evropian (BE) të mishëruara në marrëveshjen e njohur si “Green deal” e cila ka për qëllim arritjen e neutralitetit klimatik, promovimit të zhvillimit të qëndrueshëm, mbrojtjes së biodiversitetit dhe mbështetjen e tranzicionit drejt një ekonomie të gjellbër deri në vitin 2050. Plotësimi i kuadrit ligjor në sektorin e energjisë termike ka ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin e këtij sektori dhe në këtë mënyrë në realizimin e masave të shtyllës së parë të Agjendës së Gjellbër (AGj), e cila i dedikohet klimës, energjisë dhe mobilitetit. Një nga masat e parapara në kuadër të kësaj shtylle të Agjendës së Gjellbër (AGj), është rishikimi dhe plotësimi i legjislacionit relevant i cili do të mbështeste dekarbonizimin e sektorit të energjisë, gjë që edhe është objektive i këtij dokumenti. Aspektet tjera relevante të Agjendës së Gjellbër (AGj), që ndërlidhen me zhvillimin e sektorit të energjisë termike janë përmirësimi i Eficiencës së Energjisë (EE), në të gjithë sektorët, rritja e pjesëmarrjes së BRE-ve, zhvillimi i programeve për adresimin e varfërisë energjetike dhe skemave të financimit të renovimeve në sektorin e amvisërive, promovimi i teknologjive inovative etj.

1.2. Konteksti dhe problemet lidhur me energjinë termike

Ngrohja përkatësisht energjia e nevojshme për ngrohje të hapësirave dhe përgatitjen e ujit sanitar, paraqet formën dominuese të energjisë termike, edhe pse viteve të fundit si rezultati i ndryshimeve klimatike dhe rritjes së standardit, edhe energjia termike në formë të ftohjes është duke u përdorur çdo herë e më shumë. Kur bëhet fjalë për ngrohjen, kjo formë energjie në Republikën e Kosovës tradicionalisht është prodhuar nëpërmjet djegies së biomasës drusore, por në vendbanimet urbane në masë të konsiderueshme edhe duke shfrytëzuar energjinë elektrike. Ndërsa ftohja si energji termike, në sektorin rezidencial, zakonisht prodhohet nëpërmjet kondicionerëve të ajrit. Pajisjet e tilla për ftohje operojnë duke konsumuar energjinë elektrike, prandaj temperaturat e larta gjatë verës, si dhe rritja e standardit kanë bërë që në vitet e fundit rritjet e përnjëhershme të konsumit të energjisë elektrike të paraqiten jo vetëm në periudhën e dimrit, por edhe në periudha të shkurta gjatë verës. Një zhvillim i tillë, rëndon situatën e furnizimit me energji elektrike dhe në këtë mënyrë imponon nevojën e importeve të paplanifikuara e me kosto të lartë nga vendet e rajonit. Situata bëhet sidomos komplekse duke pasur parasysh që në periudhat e verës, zakonisht

¹¹<https://www.rcc.int/download/docs/Leaders%20Declaration%20on%20the%20Green%20Agenda%20for%20the%20WB.pdf/196c92cf0534f629d43c460079809b20.pdf>

realizohen remontet e rregullta të blloqeve të caktuara të Termocentraleve “Kosova A dhe Kosova B”. Kjo gjendje është shumë e pafavorshme edhe në aspektin e ndotjes mjedisore, duke pasur parasysh që energjia elektrike në Republikën e Kosovës në masën mbi nëntëdhjetë e tre për qind (93 %) prodhohet nga linjiti, djegia e të cilit rezulton në emetime të larta e të dëmshme për mjedisin.

Me qëllim të lehtësimit të kësaj situate, në dekadën e fundit Kosova ka ndërmarrë një seri masash dhe realizuar investime domethënëse si ato të lidhura me projektin e bashkëprodhimit të energjisë ndërmjet Termokosit dhe Termocentralit “Kosova B”, zgjerimin e kapaciteteve të Termokosit, integrimin e kapaciteteve gjeneruese të energjisë termike bazuar në BRE dhe realizimin e studimit për zhvillimin e njësive të bashkëprodhimit në tetë (8) komuna të Kosovës, tjera nga komunat të cilat tashmë disponojnë me kapacitet të tilla. Si rezultat i masave për zgjerimin e kapaciteteve të ngrohjes (sipas realizimit të projektit të fundit 2021-2024), janë rehabilituar, zgjeruar dhe densifikuar 40880 m gyp i rrjetit të Termokosit, janë ndërtuar treqind e njëzet e pesë (325) nënstacione të reja, dyqind e njëzet e pesë (225) nënstacione janë rehabilituar dhe tridhjetë e një (31) nënstacione janë automatizuar, ndërsa në Ngrohtoren e qytetit të Gjakovës ka pasur renovim të rrjetit sekondar dhe janë rehabilituar treqind e pesëdhjetë e pesë (355) nënstacione. Po ashtu është kryer studimi i fizibilitetit për projektin “Solar4Kosovo” të prodhimit të energjisë termike nga energjia e diellit dhe projekti përkatës është në implementim e sipër^{12,13}.

Mirëpo progresi i tillë lidhur me rritjen e sigurisë së furnizimit dhe zgjerimin e kapaciteteve ekzistuese, nuk është mbështetur me kornizën përkatëse ligjore. Për pasojë janë paraqitur pengesa ligjore konkrete lidhur me pamundësinë e përfshirjes së ngrohjes së ujit sanitar në sistemin e Ngrohjes Qendrore (NQ), nga qyteti për shkak të mungesës së planifikimit të nevojshëm të rrjetit si rezultat i mosadresimit të kësaj çështje në ligjin aktual, mënyrën e trajtimit të ndërhyrjeve arbitrare në rrjetin e ngrohjes etj., të cilat kanë përfunduar në konteste gjyqësore. Çështje tjera të cilat kërkojnë trajtim adekuat ligjor kanë të bëjnë me aspektet e funksionimit të sektorit siç janë ato lidhur me gjenerimin, shpërndarjen dhe furnizimin e energjisë termike përfshirë ato lidhur me llojin dhe strukturën e entiteteve operuese, mënyrën e zgjerimit dhe mirëmbajtjes së rrjetit, si dhe nevojën për adresim të qartë të mënyrës së qasjes në prona private dhe publike për qëllime të tilla.

Në anën tjetër, zgjerimi i kapaciteteve të Ngrohjes Qendrore (NQ), që parashihet të ndodhë në komuna tjera përveç atyre që tashmë disponojnë me sisteme të tilla Prishtina dhe Gjakova është vështirë i realizueshëm pa bashkëpunim konstruktiv dhe aktiv të autoriteteve komunale me ato qendrore. Megjithatë, korniza aktuale ligjore ka mungesë të dispozitave që kërkojnë dhe afirmojnë një bashkëpunim të tillë.

Një çështje tjetër e cila është duke u dëshmuar si shumë problematike në praktikën aktuale të funksionimit të këtij sektori dhe e cila kërkon adresim përkatës ligjor është ajo që ka të bëjë me pamundësinë e shfrytëzimit të Ngrohjes Qendrore (NQ), për ngrohjen e ujit sanitar nëpër hapësira të banimit dhe për pasojë konsumi i energjisë elektrike për këto nevoja vazhdon të jetë i lartë. Në mungesë të dispozitave përkatëse ligjore, ndërtimi i komplekseve banesore vazhdon të ndodh pa planifikimin përkatës të rrjetit të ujit të ngrohtë sanitar dhe në këtë mënyrë edhe në rrethana të

¹² <https://me.rks-gov.net/wp-content/uploads/2024/05/Raporti-i-progresit-te-Zbatimit-te-PZSEK-se-2022-2023.pdf>

¹³ <https://me.rks-gov.net/wp-content/uploads/2024/08/Raporti-i-progresit-te-Zbatimit-te-PZSEK-se-janar-qershor-2024.pdf>

mundësisë teknike për kyçje në rrjetin e Ngrohjes Qendrore (NQ), një gjë e tillë nuk mund të realizohet për shkak të mungesës së rrjetit përkatës sekondar.

Rrethanat e tilla lidhur me pamundësinë e ngrohjes së ujit sanitar, paqartësitë lidhur me përgjegjësinë e mirëmbajtës së rrjetit sekondar në hapësira të përbashkëta por edhe rrethana tjera të ngjashme janë shkaktar të ndërhyrjeve të paautorizuara dhe keqpërdorimeve tjera, për të cilat jo çdoherë janë paraparë masat e nevojshme ndëshkimore të cilat do të duhet të parandalonin rastet e tilla dhe të shërbenin për rregullim më të mirë të sektorit.

Rrjedhimisht, ndryshimet domethënëse të legjislacionit, në funksion të krijimit të kuadrit ligjor dhe institucional më të qëndrueshëm, në harmoni me kornizën ligjore të BE-së, dhe në funksion të tranzicionit energjetik, janë të domosdoshme për të siguruar progresin e nevojshëm dhe të planifikuar në sektorin e energjisë termike, si dhe për arritjen e objektivave afatgjata të këtij sektori siç parashihet me kornizën strategjike të vendit deri në vitin 2031.

Po ashtu, përkundër nevojës së shtuar për furnizim me energji termike për ftohje, ligji aktual për energjinë termike përveç në formë të definicioneve bazike nuk i referohet fare formës së energjisë termike për ftohje përkatësisht nuk përmban asnjë dispozitë ose paragraf konkret në funksion të zhvillimit dhe integritetit të sistemeve eficiente dhe miqësore ndaj mjedisit lidhur me ftohjen qendrore.

Krahas zbrazëtirave ligjore dhe adresimit jo të plotë të disa dimensioneve të zhvillimit dhe organizimit të sektorit të Ngrohjes Qendrore (NQ), e të cilat do të duhej të reflektonin rritjen e sigurisë së furnizimit viteve të fundit në fushën e këtyre sistemeve, operatorët aktual në treg (Termokosi dhe Ngrohja Qendrore Gjakova) dëshmojnë për raste të shumta të mosmarrëveshjeve ligjore me konsumatorët, si pasojë e paqartësive ekzistuese ligjore lidhur me përgjegjësinë e mirëmbajtjes dhe mënyrën e trajtimit të ndërhyrjeve të paautorizuara në rrjetin sekondar.

1.3. Orientimet strategjike të ndërlidhura me energjinë termike

Marrë në konsideratë rëndësinë e sistemeve për prodhimin, shpërndarjen dhe shfrytëzimin e energjisë termike në aspektin e integritetit të praktikave të Efiçencës së Energjisë (EE), dhe burimeve të ripërtëritshme në funksion të shfrytëzimit racional të energjisë, zvogëlimit të humbjeve energjetike dhe reduktimit të ndotjes së mjedisit, trajtimi i energjisë termike në aspekte të ndryshme zë vend të konsiderueshëm në të gjitha dokumentet relevante strategjike, si dhe në aktet përkatëse ligjore dhe nënligjore. Mënyrat e trajtimit të energjisë termike në disa prej dokumenteve kryesore strategjike janë shtjelluar në vazhdim.

Dokumenti bazik strategjik në kuadër të të cilit në forma të ndryshme është prezantuar edhe qasja strategjike lidhur me energjinë termike është **Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës për periudhën 2022-2031**. Energjia termike në këtë dokument është trajtuar kryesisht nëpërmjet njëjës prej formave kryesore të manifestimit të saj siç është ngrohja duke përfshirë edhe ngrohjen e prodhuar nëpërmjet sistemeve të kogjenerimit të energjisë.

Në lidhje me sektorin e ngrohjes në këtë dokument vihet në pah që ky është sektori me konsumin më të lartë të energjisë krahasuar me të gjithë sektorët tjerë. Po ashtu strategjia përshkruan problemet mjedisore si pasojë e shpyllëzimit të cila dukuri në anën tjetër është e ndërlidhur me

konsumin e lartë të drurit si burim energjetik në sektorin e ngrohjes. Për më tepër si rezultat i konsumit të lartë të energjisë elektrike për nevoja të ngrohjes, e cila në anën tjetër kryesisht prodhohet nga djegia e linjtit, proces ky që karakterizohet me emetime të larta të CO₂, gazeve tjera serrë dhe pluhurit, problemet mjedisore veç sa janë përkeqësuar. Konkretisht, energjia termike në formë të ngrohjes është adresuar p.sh. në kuadër të Objektivit specifik 2.3 i cili parasheh promovimin e sistemeve më eficiente dhe të pastra për ngrohje vetjake dhe qendrore duke u bazuar në shfrytëzimin e formave alternative të gjenerimit të energjisë termike p.sh. nëpërmjet BRE-ve dhe pompave termike. Ndërkaq në kuadër të Objektivit specifik 3.1, me qëllim të rritjes së numrit të ndërtesave eficiente, parashihet mbështetja e përdorimit të teknologjive eficiente për prodhimin e ngrohjes siç janë: pompat termike, si dhe sistemet solare termike. Në anën tjetër, në kuadër të Objektivit specifik 3.2 është trajtuar në mënyrë specifike energjia termike nëpërmjet parashikimit të dyfishimit të kapaciteteve ekzistuese të kogjenerimit të Termokosit dhe shtimit të së paku edhe 50 MW_{th} bazuar në energjinë solare, por edhe në formë të përmirësimit të efijencës së shpërndarjes së ngrohjes nga Termokosi dhe nga Ngrohja e Gjakovës. Në terma të përgjithshëm, në kontekstin e konsumit të energjisë dhe efijencës së energjisë (EE), Strategjia parasheh nevojën për rishikimin dhe hartimin e kornizës ligjore dhe rregullative, ashtu që të ju ofrohet më shumë hapësirë Kompanive të Shërbimeve Energjetike (ESCO), e të cilat mund të kenë një ndikim domethënës edhe në furnizimin e qëndrueshëm me energji termike. Në funksion të arritjes së caceve lidhur me Efijencën e Energjisë (EE), strategjia po ashtu parasheh rishikimin e Ligjit për Efijencë të Energjisë (EE), Ligjit për Performancën Energjetike të Ndërtesave dhe Ligjit për Burimet e Ripërtëritshme. Dy ligjet e fundit tashmë janë plotësuar/ndryshuar dhe miratuar në Kuvendin e Kosovës, ndërsa draftligji për Efijencë të Energjisë (EE), është në proces të hartimit.

Bazuar në obligimet në raport me traktatin e Komunitetit të Energjisë (KE), dhe me qëllim të harmonizimit të politikave energjetike me politikat e BE-së, në funksion të arritjes së gjendjes neutrale në aspektin e klimës deri në vitin 2050, Kosova ka hartuar draftin përkatësisht është në fazën përmbyllëse të aprovimit të Planit Kombëtar për Energji dhe Klimë (PKEK) për periudhën 2025-2030 i cili duhet të shërbej si instrument kyç për planifikimin strategjik të politikave energjetike dhe klimatike të vendit. Nëpërmjet këtij dokumenti strategjik bëhet zbërthimi i orientimeve dhe objektivave strategjike të Strategjisë së Energjisë në masa strategjike të shumëfishta nëpër sektorët përkatës. Lidhur me energjinë termike, Planit Kombëtar për Energji dhe Klimë (PKEK) për periudhën 2025-2030 ka identifikuar si një prej objektivave kryesore të tij rritjen e përdorimit të sistemeve të Ngrorjes Qendrore (NQ), duke u bazuar në parashikimin e rritjes së kërkesës për ngrohje në vitin 2030 për 2.5 herë krahasuar me kërkesën për këtë lloj energjie në vitin 2021. Në këtë funksion, si një prej masave kryesore për arritjen e objektivave strategjike, Planit Kombëtar për Energji dhe Klimë (PKEK) për periudhën 2025-2030, ka paraparë rikonstruktimin dhe zgjerimin e rrjetit të Ngrorjes Qendrore (NQ), ndërkaq si një ndër akterët tjerë kyç për implementimin e Planit Kombëtar për Energji dhe Klimë (PKEK) për periudhën 2025-2030, ka identifikuar kompanitë e Ngrorjes Qendrore (NQ). Shikuar në aspektin teknologjik, rritja e kapaciteteve të Ngrorjes Qendrore (NQ), përveç nëpërmjet zgjerimit të mundësive të kogjenerimit me Termocentralin “Kosova B”, në masë të konsiderueshme është planifikuar të arrihet nëpërmjet sistemit solar të Ngrorjes Qendrore (NQ), në kuadër të projektit “Solar4Kosova II”. Si një prej masave tjera në funksion të dekarbonizimit, rritjes së Efijencës së Energjisë (EE), sigurisë

energjetike dhe dimensionit të rregullimit të tregut të brendshëm energjetik Planit Kombëtar për Energji dhe Klimë (PKEK) për periudhën 2025-2030, ka numëruar edhe studimin e fizibilitetit për Ngrohje Qendrore (NQ), në tetë (8) komuna nga i cili pritet të nxirret përfundimi lidhur me fizibilitetin tekniko-ekonomik të sistemeve të Ngrohjes Qendrore (NQ), që funksionojnë nëpërmjet BRE-ve p.sh. biomasës, energjisë gjeotermike dhe pompave solar termike.

Në linjë me orientimet strategjike, Republika e Kosovës me miratimin e dy ligjeve të reja që mbulojnë fushën e energjisë përkatësisht fillimin e hartimit të ligjit për Eficiencën e Energjisë (EE), në disa aspekteve që lidhen me energjinë termike e të cilat do të diskutohen në seksionin përkatës në vijim, ka shënuar një progres të matshëm. Megjithatë energjia termike, në mënyrë specifike ajo që prodhohet dhe shpërndahet nëpërmjet sistemeve të Ngrohjes Qendrore (NQ), deri më tani është trajtuar në kuadër të Ligjit aktual në fuqi Nr. 05/L-052 për Energjinë Termike të miratuar në vitin 2015. Mirëpo, edhe pse miratimi i këtij ligji në vitin 2015 mund të konsiderohet një progres domethënës në sektorin e energjisë, ashtu siç u cek në kuadër të hyrjes dhe seksionit 1.2 në praktikën e zbatimit të tij janë shënuar mangësi dhe boshllëqe të cilat duhet të adresohen në mënyrë efektive nëpërmjet kornizës ligjore të përditësuar. Përditësimi i bazës ligjore duhet të bëhet para së gjithash me qëllim të adresimit të mangësive konkrete tashmë të cekura siç janë ato që kanë të bëjnë me paqartësitë rreth mënyrës së faturimit të energjisë termike për hapësirat e përbashkëta, pamundësinë e shfrytëzimit të energjisë termike për ngrohjen e ujit sanitar, mënyrës së trajtimit të ndërhyrjeve të konsumatorëve në rrjetin e ngrohjes, mungesë së adresimit të rolit të autoriteteve komunale për zgjerimin e kapaciteteve të kogjenerimit, mënyrës së promovimit të konkurrencës si dhe transpozimin më të plotë të dispozitave relevante nga korniza ligjore e BE-së, (koston e shërbimit në raste specifike, afateve lidhur me njehsorët inteligjent, nivelit të BRE-ve, të shfrytëzuara). Përveç arsyeve të tilla, vet koha e miratimit të ligjit aktual ka pamundësuar përfshirjen e disa prej dimensioneve të energjisë termike e të cilat imponohen bazuar në zhvillimet dinamike të sektorit të energjisë në dekadën e fundit e të cilat tashmë janë përfshirë në kornizën përkatëse ligjore të BE-së.

1.4. Dokumentet e politikave, legjislacionit dhe institucionet përgjegjëse

Siç u nënvizua tashmë disa herë, koncepti i energjisë termike është ngushtë i lidhur me forma tjera të energjisë, prandaj edhe trajtimi gjithëpërfshirës i saj kërkon marrjen në konsideratë të tërë peizazhit të politikave energjetike si p.sh: prodhimin e energjisë, Eficiencën e Energjisë (EE), Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë (BRE), sigurinë e furnizimit, rregullimin e tregut, ndikimin në mjedis etj. Adresimi adekuat i tërë dimensioneve të tillë të politikave energjetike ndër vite, natyrisht ka imponuar nevojën e hartimit, aprovimit dhe zbatimit të një spektri të gjerë të dokumenteve strategjike, ligjore e nënligjore nga institucionet përgjegjëse. Një përmbledhje e dokumenteve strategjike e ligjore dhe institucioneve përgjegjëse është prezantuar në tabelën vijuese.

Tabela 2: Dokumentet e politikave, ligjet, aktet nënligjore dhe institucionet

Dokumenti i politikave, ligji ose akti në nënligjor	Marrëdhënia me dokumentin e politikave ose të	Institucioni /et shtetëror/e	Objekti/funksioni/qëllimi
---	---	------------------------------	---------------------------

	planifikimit nëpërmjet internetit ose akteve ligjore në Gazetën Zyrtare (GZ)	përgjegjës/e për zbatim	
Strategjia për Energji e Republikës së Kosovës për periudhën 2022-2031.	https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/03/Strategjia-e-Energjise-e-Republikës-së-Kosovës-2022-2031.pdf	Qeveria e Republikës së Kosovës (QRK) Ministria e Ekonomisë (ME) Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRë) Të gjitha institucionet publike.	Strategjia e Energjisë ka përcaktuar pesë objektiva strategjike: 1. Përmirësimi i besueshmërisë së sistemit; 2. Dekarbonizimi dhe promovimi i energjisë së ripërtëritshme; 3. Rritja e Eficiencës së Energjisë (EE); 4. Forcimi i bashkëpunimit rajonal dhe funksionimit të tregut; 5. Mbrojtja dhe fuqizimi i konsumatorëve.
Programi i zbatimit të Strategjisë së Energjisë së Kosovës (PZSEK) për periudhën 2022-2025.	https://me.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/10/PZSEK-2022-2025_SHQ.pdf	Qeveria e Republikës së Kosovës (QRK) Ministria e Ekonomisë (ME) Ministria e Financave (MFPT) Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRë) Operatori i Transmisionit, Sistemit dhe Tregut Kompania Kosovare e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Kompania Kosovare e Furnizimit me	Programi për Zbatimin e Strategjisë së Energjisë së Kosovës (PZSEK) për periudhën 2022-2025 është dokument themelor trevjeçar (3) për zhvillimin e sektorit të energjisë. Ky dokument paraqet aktivitetet e detajuara për zbatimin e masave të parashikuara në Strategjinë e Energjisë së Republikës së Kosovës për periudhën 2022-2031.

		Energji Elektrike	
Ligji Nr. 08/L-201 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 05/L-081 për Energjinë.	https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=79160	Ministria e Ekonomisë (ME) Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRë)	Ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 05/L-081 për Energjinë (“Ligji bazik”) për të përcaktuar masat e kursimit të energjisë gjatë periudhës së masave emergjente, mbikëqyrjen e zbatimit të masave të kursimit, si dhe dispozitat ndëshkuese.
Ligji Nr. 05/L-081 për Energjinë.	https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=12689	Ministria e Ekonomisë (ME) Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRë)	Përcakton parimet e përgjithshme përmes të cilave drejtohen veprimtaritë në sektorin e energjisë në Republikën e Kosovës, me qëllim të garantimit të furnizimit të sigurt, të qëndrueshëm dhe të cilësisë së lartë me energji, për të krijuar kushte për një treg të hapur funksional, transparent dhe konkurrues. Harton politikat e energjisë dhe ka përgjegjësi mbi inspektimin, monitorimin dhe planifikimin e zhvillimit të sektorit të energjisë.
Ligji Nr. 08/L-258 për Promovimin e Përdorimit të Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë (BRE).	https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=89043	Ministria e Ekonomisë (ME) Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRë)	Përcakton kornizën e përgjithshme për promovimin e përdorimit të energjisë nga burimet e ripërtëritshme në Republikën e Kosovës, me qëllim të rritjes së përdorimit të energjisë nga burimet e ripërtëritshme dhe bashkëprodhimit në sektorin e energjisë elektrike, në sektorin e ngrohjes dhe ftohjes dhe sektorin e transportit, me qëllim të përmbushjes së nevojave për energji, rritjes së sigurisë së furnizimit, përmirësimit dhe mbrojtjes së mjedisit, si dhe ofrimit të përfitimeve sociale dhe shëndetësore dhe promovimit

			të mundësive të barabarta të punësimit në sektorin e energjisë.
Ligji Nr. 06/L-079 për Efiçencë të Energjisë (EE).	https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18216	Ministria e Ekonomisë (ME) Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRë)	Përcakton kornizën ligjore të domosdoshme për promovimin dhe përmirësimin e Efiçencës së Energjisë (EE), në Republikën e Kosovës, me qëllim të përcaktimit të caqeve të Efiçencës së Energjisë (EE), dhe arritjen e këtyre caqeve në zbatim të planeve të veprimit për Efiçencë të Energjisë (EE), zhvillimin e tregut të shërbimeve energjetike dhe masat tjera të Efiçencës së Energjisë (EE), dhe rregullon aktivitetet që kanë për qëllim zvogëlimin e intensitetit energjetik në ekonominë shtetërore dhe që i kontribuojnë zvogëlimit të ndikimit negativ në mjedis të aktiviteteve që ndërlidhen me sektorin e energjisë.
Ligji Nr. 08/L-242 për Performancën Energjetike të Ndërtesave.	https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=92131	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI).	Ka për qëllim përcaktimin e rregullave, procedurave dhe masave për përmirësimin e performancës energjetike në ndërtesa, duke i marrë parasysh kushtet e jashtme dhe lokale klimatike, si dhe kërkesat për klimën e brendshme dhe koston-efektive.
Ligji Nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike.	https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=12744	Ministria e Ekonomisë (ME) Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRë) KOSTT	Përcakton rregullat dhe masat për funksionimin e sektorit të energjisë elektrike për të garantuar furnizim të sigurt, të rregullt dhe cilësor me energji elektrike, me çmime reale, duke pasur në konsideratë ruajtjen e mjedisit dhe shfrytëzimin efikas të saj. Përcakton rolin, obligimet dhe përgjegjësitë e akterëve të ndryshëm në sektor të energjisë.

Ligji Nr. 05/L-052 për Energjinë Termike.	https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=11326	Ministria e Ekonomisë (ME) Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRë) Ngrohtoret	Përcakton kushtet për zhvillimin e tregut të qëndrueshëm dhe konkurrues të energjisë termike për ngrohje/ftohje të përqendruar, sipas ekonomisë së tregut të lirë, plotësimit të kërkesës së konsumatorit dhe mbrojtjes së mjedisit, furnizim të sigurt, të qëndrueshëm dhe eficient me energji termike, për ngrohjen/ftohjen e hapësirave, ngrohjen e ujit sanitar dhe ujit industrial konsumatorët që të gëzojnë të drejtë për t'u kyçur në sistemet e energjisë termike, dhe për t'u furnizuar me energji termike sipas standardeve dhe me çmim ekonomik.
Ligji Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë.	https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=12694	Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRë) Ministria e Ekonomisë (ME)	Përcakton kompetencat, detyrat dhe funksionet e Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRë), përfshirë kushtet për dhënien e licencave për kryerjen e aktiviteteve në fushën e energjisë, certifikimin e aktiviteteve të operatorëve të transmetimit në sektorin e energjisë procedurat për dhënien e autorizimeve për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese, krijimin dhe funksionimin efikas të tregjeve konkurruese, mbrojtjen e konsumatorit, si dhe kriteret për rregullimin e tarifave dhe kushtet për furnizim me energji.
Udhëzim Administrativ Nr. 09/2017 për Zyrat Komunale të Energjisë (ZKE).	https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=15305	Ministria e Ekonomisë (ME) Zyrat Komunale për Energji (ZKE)	Përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrave Komunale të Energjisë (ZKE), për adresimin e çështjeve në planifikim, zbatim dhe monitorim të politikave të energjisë në nivel lokal.
Udhëzim Administrativ Nr. 02/2023 për Cakun e	https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=82827	Ministria e Ekonomisë (ME)	Ka për qellim përcaktimi e caktimit afatgjatë dhe vjetor të pjesëmarrjes së energjisë nga

Energjisë Elektrike nga Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë (BRE).		Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRë)	burimet e ripërtëritshme në konsumin përfundimtar bruto të energjisë elektrike.
Udhëzim Administrativ Nr.01/2023 për Promovimin e Energjisë nga Burimet e Ripërtëritshme.	https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=73462	Ministria e Ekonomisë (ME)	Ka për qëllim përcaktimin e llojeve të Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë (BRE) që shfrytëzohen për prodhimin e energjisë elektrike dhe termike, centralet që mbështeten për shfrytëzimin e burimeve të ripërtëritshme për prodhimin e energjisë kushtet e përdorimit dhe standardet teknike, promovimin e Skemës Mbështetëse (SM), dhe masat për bashkëpunim siç janë: transferi statistikor, skemat e përbashkëta mbështetëse dhe projektet e përbashkëta për plotësimin e caqeve të burimeve të ripërtëritshme.
Udhëzimi Administrativ Nr. 05/2017 Caqet e Energjisë nga Burimet e Ripërtëritshme.	https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=14893	Ministria e Ekonomisë (ME) Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRë)	Përcaktimi i caktuar afatgjatë dhe vjetor të pjesëmarrjes së energjisë nga burimet e ripërtëritshme në konsumin përfundimtar bruto të energjisë elektrike.
Udhëzim Administrativ Nr.06/2021 për Shërbimet e Energjisë (ESCO).	https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=51726	Ministria e Ekonomisë (ME)	Ka për qëllim promovimin e zhvillimit të tregut kombëtar të shërbimeve të energjisë në Republikën e Kosovës duke përcaktuar rregullat dhe procedurat për operimin e kompanive të shërbimeve të energjisë (ESCO).
Udhëzim Administrativ Nr.05/2021 për Kornizën e Përgjithshme të Raportimit për Eficiencë të Energjisë (EE).	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=51516	Ministria e Ekonomisë (ME)	Përcakton kornizën e përgjithshme të raportimit për Planin Kombëtar të Veprimit për Eficiencë të Energjisë (PKVEE), dhe Raportin Vjetor të Progresit duke përfshirë edhe kërkesat për raportim.
Udhëzim Administrativ Nr. 10/2020 për Metodën dhe Parimet e	https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=35757	Ministria e Ekonomisë (ME)	Përcakton metodat dhe parimet e përbashkëta për llogaritjen e

Përbashkëta për Llogaritjen e Ndikimit të Efiçencës së Energjisë (EE).			ndikimit të Efiçencës së Energjisë (EE).
Rregullore Nr.02/2020 për Kërkesat Minimale për Faturimin dhe Informacionin e Faturimit Bazuar në Konsumin Aktual.	https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=35759	Ministria e Ekonomisë (ME)	Përcakton kërkesat minimale për faturimin dhe informacionin bazuar në konsumin final.
Rregullore Nr. 01/2020 për Kriteret Minimale për Auditimet e Energjisë Përfshirë ato të Kryera si Pjesë e Sistemeve të Menaxhimit të Energjisë.	https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=33603	Ministria e Ekonomisë (ME)	Përcakton kriteret minimale për auditimet e energjisë përfshirë ato të kryera si pjesë e sistemeve të menaxhimit të energjisë deri në masën që kjo është teknikisht e realizueshme.
Udhëzimi Administrativ Nr.08/2020 për Certificate/ Garancinë e Origjinës për Energjinë Elektrike të Prodhuar nga Bashkëprodhimi me Efiçencë të Energjisë (EE).	https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=33495	Ministria e Ekonomisë (ME)	Përcakton kërkesat në lidhje me Certificate/Garancinë e origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga bashkëprodhimi me efiçencë të lartë.
Udhëzim Administrativ Nr.07/2020 për Kushtet e Përgjithshme për Analizën e Kosto Përfitimit në Lidhje me Masat për Promovimin e Efiçencës së Energjisë (EE) në Ngrohje dhe Ftohje.	https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=31869	Ministria e Ekonomisë (ME)	Përcakton kushtet e përgjithshme për analizën e kosto-përfitimit në lidhje me masat për promovimin e Efiçencës së Energjisë (EE) në ngrohje dhe ftohje.
Udhëzim Administrativ Nr.06/2020 për Llogaritjen e Energjisë Elektrike nga Bashkëprodhimi.	https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=31194	Ministria e Ekonomisë (ME)	Përcakton parimet e përgjithshme për llogaritjen e energjisë elektrike nga bashkëprodhimi, duke siguruar në këtë mënyrë llogaritjen e duhur të energjisë elektrike nga procesi i bashkëprodhimit.

Udhëzim Administrativ Nr.04/2020 për Potencialin e Eficiencës së Energjisë (EE) në Ngrohje dhe Ftohje.	https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=30543	Ministria e Ekonomisë (ME)	Përcakton vlerësimin gjithëpërfshirës të potencialit të Eficiencës së Energjisë (EE) në ngrohje dhe ftohje.
Udhëzim Administrativ (MZHE) Nr. 02/2017 lidhur me llojin dhe sasinë e rezervave minimale të lëndës djegëse ose të kapacitetit prodhues rezervë për ndërmarrjet e energjisë termike.	https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=13427	Ministria e Ekonomisë (ME)	Ka për qëllim përcaktimin e llojit dhe sasinë e rezervave minimale të lëndës djegëse, ose të kapacitetit prodhues rezervë për ndërmarrjet e energjisë termike që ka të bëjë me masat mbrojtëse afatshkurtra të sigurisë së furnizimit, plotësimit të kërkesës së konsumatorit, furnizim të sigurt të qëndrueshëm dhe eficient me energji termike, për ngrohjen/ftohjen e hapësirave dhe ngrohjen e ujit sanitar.
Rregullore Nr. 05/2020 për Sistemin e Ofruesve të Shërbimit Energjetik dhe Kriteret Minimale për Auditimin Energjetik.	https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=28177	Ministria e Ekonomisë (ME)	Vendos procedurat për funksionalizimin e sistemit për ofruesit e shërbimeve energjetike, përfshirë auditorët e energjisë, vlerësuesit e energjisë dhe ekspertët e pavarur për trajnimin dhe certifikimin, regjistrimin, monitorimin dhe zbatimin.
Rregullore Nr. 02/18 për Metodologjinë Kombëtare për Kalkulimin e Performancës së Integruar Energjetike të Ndërtesave.	https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18295	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI)	Përcakton metodologjinë e kalkulimit e cila përdoret për vlerësimin e performancës energjetike në ndërtesa të Republikës së Kosovës dhe përdoret për të: • Demonstruar plotësimin e standardeve minimale të performancës energjetike në ndërtesën e caktuar, në fazën e projektimit dhe në etapat e hershme të ndërtimit; • Gjeneruar certifikatën e performancës energjetike

			për ndërtesa të reja dhe ekzistuese;
Rregullore Nr. 03/18 për Procedurën e Certifikimit të Performancës Energjetike në Ndërtesë.	https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18296	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI)	Ka për qëllim përcaktimin e procedurave për Certifikimin e Performancës Energjetike në Ndërtesë duke pasur parasysh metodologjinë e kalkulimit, vlerësuesit e energjisë, certifikimin, monitorimin dhe zbatimin.
Rregullore Nr. 04/18 për Kërkesat Minimale të Performancës Energjetike të Ndërtesave.	https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18297	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI)	Përcakton kërkesat minimale për performancën energjetike në ndërtesa të reja dhe në njësitë e ndërtesave që rinovohen apo rindërtohen në mënyrë që të arrihen nivelet e kosto optmale për kategori të ndryshme të ndërtesave.
Rregullore nr.01/2018 për Inspektimin e Sistemeve të Ngrohjes dhe Sistemeve për Kondicionim të Ajrit.	https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=16142	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI)	Përcakton rregullat e inspektimit të sistemeve të ngrohjes dhe sistemeve të kondicionimit të ajrit të instaluar në ndërtesë, me qëllim të identifikimit të mangësive të dukshme, raportimit për gjendjen e përgjithshme, eficientë dhe kapacitetin e sistemit në raport me kërkesat e ndërtesës dhe të rekomandoj përmirësimi me kosto efektive.
Rregulla për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.	https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=92746	Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRë)	Ka për qëllim të krijoj një procedurë publike, transparente dhe jodiskriminuese të licencimit, që promovon themelimin e një sektori konkurrues të energjisë, të nxis investimet duke siguruar stabilitetin dhe sigurinë e furnizimit me energji në Republikën e Kosovës.
Rregulla për vetëkonsumatorët me Burime të Ripërtitshme.	https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=92747	Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRë)	Ka për qëllim të përcaktoj parimet dhe mekanizmin e rregulluar për mbështetjen e konsumatorëve të energjisë elektrike që dëshirojnë të gjenerojnë energji elektrike në

			ambientet e tyre bazuar në teknologjinë e ripërtëritshme për përdorim vetanak.
Rregulla Nr. 03/2022 për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapacitete të Reja Gjeneruese, Sistemeve të Reja të Transmisionit dhe Distribucionit të Gazit, përfshirë Interkonektorët, Tubacionet Direkte për Energji Termike dhe Linjat Direkte të Energjisë Elektrike dhe Tubacionet Direkte të Transmisionit të Gazit Natyror (GN).	https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=92726	Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRÉ)	Ka për qëllim të përcaktoj procedurën për lëshimin e Autorizimit për Ndërtim të Kapaciteteve të Reja Gjeneruese, Sistemeve të Reja për Transmisionin dhe Distribucionin të Gazit, duke përfshirë Interkonektorët, Tubacionet Direkte për Energjinë Termike dhe Linjat Direkte të Energjisë Elektrike dhe Tubacionet Direkte për Transmisionin e Gazit Natyror (GN).

1.5. Aspekte të harmonizimit me bazën ligjore të BE-së

Nëpërmjet nënshkrimit të Traktatit të Komunitetit të Energjisë (TKE), në vitin 2005 Republika e Kosovës, ngjashëm si edhe vendet tjera nënshkruese ka marrë përsipër obligimin që të transponoj në kornizën ligjore vendore të gjitha aktet ligjore relevante të BE-së, në fushën e energjisë, mjedisit dhe konkurrencës. Aktet e tilla ligjore të BE-së, janë pjesë integrale e politikave të Marrëveshjes së gjelbër të BE-së^{14,15} dhe të njëjtat i nënshtrohen rishikimit dhe plotësim/ndryshimit të vazhdueshëm në funksion të realizimit të arritjes së neutralitetit klimatik deri në vitin 2050. Me nënshkrimin e Deklaratës së Sofjes për Agjendën e Gjelbër të Ballkanit Perëndimor¹⁶ edhe Kosova së bashku me vendet tjera të Ballkanit Perëndimor janë zotuar të arrijnë neutralitetin klimatik e në këtë mënyrë edhe të përcjellin dinamikën e politikave energjetike të BE-së.

Bazën e politikave të BE-së ,në aspektin e energjisë termike përkatësisht energjisë për nevoja të ngrohjes dhe ftohjes e përbëjnë Planet Kombëtare për Energji dhe Klimë (PKEK) dhe direktivat përkatëse lidhur me Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë (BRE), Efiçencën e Energjisë (EE) dhe Performancën Energjetike të Ndërtesave¹⁷. Planet Kombëtare për Energji dhe Klimë (PKEK) për periudhën 2021-2030¹⁸ të vendeve anëtare të BE-së, të miratuara në vitin 2019, përmbajnë caqet energjetike dhjetë (10) vjeçare dhe janë në zbatim e sipër. Siç u potencia më lartë, edhe Kosova

¹⁴ [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2024/757637/EPRS_BRI\(2024\)757637_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2024/757637/EPRS_BRI(2024)757637_EN.pdf)

¹⁵ <https://assets.kpmg.com/content/dam/kpmg/xx/pdf/2022/01/green-deal-policy-guide-web-2022.pdf>

¹⁶ <https://www.rcc.int/docs/546/sofia-declaration-on-the-green-agenda-for-the-western-balkans-rn>

¹⁷ <https://www.interregeurope.eu/sites/default/files/2023-07/Decarbonising%20heating%20and%20cooling.pdf>

¹⁸ https://commission.europa.eu/energy-climate-change-environment/implementation-eu-countries/energy-and-climate-governance-and-reporting/national-energy-and-climate-plans_en

në kuadër të obligimeve në raport me Traktatin e Komunitetit të Energjisë (TKE) ka hartuar draftin dhe është në fazën e aprovimit final të Plani Kombëtar për Energji dhe Klimë (PKEK) për periudhën 2025-2030. Në anën tjetër, direktivat kryesore të BE-së, lidhur me energjinë termike, të miratuara nga Komuniteti i Energjisë (KE) dhe aktualisht në fuqi janë¹⁹:

- Direktiva (EU) 2018/2001 për Promovimin e përdorimit të Energjisë nga Burimet e Ripërtëritshme;
- Direktiva 2012/27/EU për Eficiencën e Energjisë (EE) dhe Direktiva (EU) 2018/2002 që e ndryshon Direktivën 2012/27/EU;
- Direktiva 2010/31/EU për Performancën Energjetike të Ndërtesave.

Disa prej aspekteve kryesore të adresuara në Direktiva (EU) 2018/2001 për Promovimin e përdorimit të Energjisë nga Burimet e Ripërtëritshme të cilat kanë të bëjnë me informimin e konsumatorëve, trajnimin e instaluesve, minimumin e pjesëmarrjes së BRE-ve, në ngrohje/ftohje të ndërtesave, potencialin e BRE-ve, për ngrohje/ftohje, qasjen dhe operimin e rrjetit, si dhe specifikat e ngrohjes/ftohjes qendrore janë:

- Nëpërmjet informatave lehtësisht të qasshme (në uebfaqe ose faturën përkatëse), konsumatorët të informohen për performancën energjetike dhe pjesëmarrjen e BRE-ve, në sistemet e tyre të ngrohjes/ftohjes qendrore;
- Në fushën e ngrohjes/ftohjes qendrore duhet parandaluar bllokimi rregullator the teknologjik në mënyrë që të njëjtëve të ju mundësohet ndërrimi i karburantit dhe kalimi në burime të ripërtëritshme përkatësisht konsumatorëve duhet lehtësuar zgjedhjen ndërmjet e opsioneve me performancë më të lartë energjetike;
- Konsumatorëve duhet të ju ofrohet mbrojtje në procesin e largimit të tyre nga sistemet jo eficiente të ngrohjes/ftohjes, dhe të ju mundësohet prodhimi vetjak e ngrohjes/ftohjes nga burimet e ripërtëritshme me performancë energjetike dukshëm më të mirë;
- Në kodet e ndërtimit, për ndërtesat e reja dhe ato ekzistuese të cilat parashihet t'i nënshtrohen renovimit domethënës, të parashihet minimumi i përdorimit të burimeve të ripërtëritshme për aq sa është i arsyeshëm në aspektin teknik, funksional dhe ekonomik;
- Të bëhet vlerësimi i potencialit i Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë (BRE) për ngrohje dhe energjisë së humbur termike për ngrohje/ftohje;
- Të zhvillohen dhe të zbatohen skemat e certifikimit/kualifikimit të instaluesve të teknologjive të burimeve të ripërtëritshme;
- Të sigurohet dhënia e udhëzimeve akterëve relevant në veçanti planifikueseve dhe arkitektëve për marrjen në konsideratë në mënyrë adekuate mundësinë e kombinimit optimal të BRE-ve, teknologjive energji-eficiente, dhe sistemeve të ngrohjes/ftohjes

¹⁹ <https://www.energy-community.org/legal/acquis.html>

qendrore gjatë planifikimit, dizajnit dhe renovimit të hapësirave industriale, komerciale dhe rezidenciale;

- Bazuar në Planin për Energji dhe Klimë, të ndërmerren veprimet e nevojshme për zhvillimin e infrastrukturës së ngrohjes/ftohjes qendrore me qëllim të akomodimit të ngrohjes/ftohjes nga BRE-të, dhe nga energjia termike e humbur;
- Të përcaktohet mënyra e realizimit të rritjes së pjesëmarrjes së BRE-ve, për nevoja të ngrohjes/ftohjes, në mënyrë që të arrihet përqindja (%) vjetore e rritjes e specifikuar në kuadër të artikullit njëzet e tre (23) të Direktivës.

Aspekte relevante të ndërlidhura me energjinë termike të cilat kanë të bëjnë me mënyrën e matjes së ngrohjes/ftohjes qendrore, mënyrën e përcaktimit të kostos së ngrohjes/ftohjes, mënyrën e faturimit dhe informimit për ngrohje/ftohje, koston e matjes dhe faturimit, promovimin e ngrohjes/ftohjes eficiente dhe kushtet e mbështetjes së kogjenerimit, janë të adresuara edhe brenda Direktivës 2012/27/EU për Eficiencën e Energjisë (EE) dhe Direktivës (EU) 2018/2002 që e ndryshon Direktivën 2012/27/EU, p.sh.:

- Realizimi i matjes me njehtor të saktë dhe kosto-efektiv;
- Mënyra e realizimit të matjes në rastin kur konsumatori pjesërisht shfrytëzon ngrohjen/ftohjen qendrore e pjesërisht atë të gjeneruar nga pajisjet individuale;
- Nevoja që matësit e instaluar pas 30 tetorit 2023 të mund të lexohen nga distanca;
- Faturimi dhe informimi lidhur me konsumin të jetë i besueshëm, i saktë dhe i bazuar në konsumin aktual;
- Informimi lidhur me historinë e koston dhe konsumit, edhe në formë elektronike;
- Realizimi i vlerësimit gjithëpërfshirës lidhur me potencialin e aplikimit të kogjenerimit me eficiencë të lartë ngrohjes/ftohjes eficiente qendrore;
- Aprovimi i politikave promovuese të shfrytëzimit në nivel lokal dhe regjional të sistemeve të ngrohjes/ftohjes në veçanti të atyre të ndërlidhura me kogjenerimin me eficiencë të lartë;
- Rastet kur palët nënshkruese të traktatit duhet të sigurojnë kryerjen e analizës kosto-efektive lidhur me instalimet e energjisë termike me fuqi më të madhe se 20 MW;
- Nevoja për ndërmarrjen e masave në funksion të zhvillimit të infrastrukturës së për ngrohjes/ftohjen eficiente qendrore, në rastet e identifikimit të potencialit përkatës për aplikimin e kogjenerimit eficient dhe ngrohjes/ftohjes qendrore.

Direktiva tjetër relevante në kontekstin e energjisë termike përkatësisht Direktiva 2010/31/EU për Performancën Energjetike të Ndërtesave adreson para së gjithash kërkesat minimale, mënyrën e vlerësimit, certifikimit dhe inspektimit të sistemeve të ngrohjes, klimatizimit dhe përgatitjes së ujit të ngrohtë sanitar si komponente të rëndësishme teknike dhe me ndikim domethënës në vlerësimin e performancës energjetike të ndërtesave. Mirëpo, direktiva adreson edhe disa aspekte specifike të energjisë termike që lidhen me sistemet e ngrohjes/ftohjes qendrore, si:

- Nevoja që vendet anëtare të ju mundësojnë dhe nxisin arkitektët dhe planifikuesit që në mënyrë adekuate të marrin në konsiderim kombinimin optimal të Efiçencës së Energjisë (EE), përdorimit të BRE-ve, dhe sistemeve të ngrohjes/ftohjes qendrore gjatë planifikimit, dizajnit, ndërtimit dhe renovimit të hapësirave industriale dhe rezidenciale;
- Për ndërtesat e reja, para se të filloj ndërtimi i tyre, ndër të tjera duhet të merret parasysh studimi i fizibilitetit teknik, mjedisor dhe ekonomik lidhur me ngrohjen/ftohjen qendrore ose në bllok, sidomos në rastet kur sistemi i tillë bazohet tërësisht ose pjesërisht në energjinë nga BRE-të.

Direktivat e Komunitetit të Energjisë (KE), të listuara dhe të komentuara më sipër, në aspektin e energjisë termike janë transpozuar pjesërisht në kornizën ligjore të Republikës së Kosovës, nëpërmjet ligjeve vijuese:

- Ligji Nr. 08/L-258 për Promovimin e Përdorimit të Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë (BRE) viti 2024;
- Ligji Nr. 06/L-079 për Efiçencë të Energjisë (EE) viti 2018- ligji i ri aktualisht në proces të miratimit;
- Ligji Nr. 08/L-242 për Performancën Energjetike të Ndërtesave viti 2024.

Në aspektin e mënyrës së trajtimit dhe përmbajtjes në raport me energjinë termike, Ligji Nr. 08/L-258 për Promovimin e Përdorimit të Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë (BRE) shënon një progres domethënës duke trajtuar çështjet si:

- Aspektet e informimit të konsumatorëve;
- Skemat e certifikimit/kualifikimit të instaluesve të teknologjive të BRE-ve;
- Promovimin e përdorimit të BRE-ve, për ngrohje dhe ftohje;
- Masat për rritjen e pjesëmarrjes së BRE-ve, në sektorin e ngrohjes dhe ftohjes;
- Masat stimuluese për përdorimin e BRE-ve, ose energjisë termike të humbur për nevoja të ngrohjes/ftohjes;
- Obligimin e operatorit të sistemit termik për lidhjen dhe blerjen e energjisë termike për nevoja të ngrohjes/ftohjes të prodhuar nga palët e treta;
- Të drejtën e konsumatorëve për tu informuar nga furnizuesit e ngrohjes/ftohjes qendrore në mënyrë adekuate lidhur me performancën energjetike dhe pjesën e BRE-ve;
- Lidhjen e çdo ndërtese të re me sistem efiçient të ngrohjes/ftohjes qendrore.

Ligji Nr. 06/L-079 për Efiçencë të Energjisë (EE) viti 2018, përveç tjerash adreson aspekte vijuese lidhur me energjinë termike:

- Mënyrën e matjes së energjisë termike për ngrohje/ftohje;
- Përshkrim të detajuar të mënyrës së informimit të konsumatorëve lidhur me konsumin, përfshirë edhe historinë e konsumit për së paku tri (3) vitet paraprake;

- Vlerësimin gjithëpërfshirës të potencialit për aplikimin e bashkëprodhimit me eficiencë të lartë si dhe eficiencës së ngrohjes dhe ftohjes;
- Rastet kur investitorët ose operatorët detyrohen të bëjnë analizën kosto-efektive të nivelit të instalimeve të energjisë termike me fuqi mbi 20 MW;
- Mundësinë e propozimit të masave adekuate për zhvillimin e infrastrukturës së ngrohjes/ftohjes eficiente nga largësia, në rast se studimi përkatës identifikon potencialin e caktuar.

Në kuadër të rishikimit të paketës së ligjeve kryesore në fushën e energjisë, aktualisht është hartuar drafti i Ligjit të ri për Eficiencë të Energjisë (EE) dhe Grupi Punues (GP) përkatës është në proces të finalizimit të draftit. Lidhur me energjinë termike, drafti aktual i ligjit për Eficiencë të Energjisë (EE), adreson aspektet kryesore, të cilat edhe u prezantuan më sipër, përjashtimisht aspektit të matjes së energjisë së konsumuar dhe informimit të konsumatorëve, të cilat parashihen të adreson nëpërmjet udhëzimit përkatës administrativ.

Ngjashëm si edhe Direktiva e BE-së, për performancën energjetike të ndërtesave, edhe Ligji i Kosovës Nr. 08/L-242 për Performancën Energjetike të Ndërtesave, ka në fokus adresimin e aspekteve që lidhen me mënyrën e inspektimit të sistemeve të ngrohjes, klimatizimit dhe përgatitjes së ujit të ngrohtë sanitar, mënyrën e vlerësimit të performancës energjetike të tyre, mënyrën e certifikimit të ndërtesave nga aspekti i performancës së tyre, të dhënat të cilat duhet t'i përmbaj certifikata e performancës energjetike etj. Në mënyrë specifike, lidhur me energjinë termike në formë të ngrohjes/ftohjes qendrore, ligji parasheh si vijon:

- Nevojën për shqyrtimin e mundësisë së përdorimit të sistemeve alternative të ngrohjes/ftohjes qendrore, në veçanti atyre që përdorin BRE-të, në rastin e projektimit të ndërtesave të reja ose atyre që in nënshtrohen ndonjë renovimi të madh;
- Nevojën për instalimin e njehsorëve të ngrohjes/ftohjes qendrore në rastin e projektimit të ndërtesave të reja ose atyre që in nënshtrohen ndonjë renovimi të madh.

Krahas tri (3) ligjeve kryesore të cilat adresojnë aspekte të ndryshme lidhur me energjinë termike, në Republikën e Kosovë është në fuqi edhe ligji për energjinë termike i miratuar në dhjetor të vitit 2015 e i cili ka për objektiv rregullimin e specifikave të energjisë termike në formë të Ngrohjes Qendrore (NQ), siç janë prodhimi, shpërndarja, furnizimi, të drejtat dhe përgjegjësit e konsumatorit, qasja në rrjet, matja, pajisjet matëse, kodet teknike dhe dispozitat ndëshkimore.

Përkundër faktit që baza ligjore e Republikës së Kosovës përfshirë këtu edhe ligjin për energjinë termike është mjaft e konsoliduar, në kontekstin e nivelit dhe mënyrës së adresimit të disa aspekteve të trajtuara nga Direktivat e BE-së, korniza aktuale ligjore e Republikës së Kosovës nuk adreson në tërësi disa dimensione të energjisë termike. Në këtë kontekst nuk janë adresuar në tërësi ose fare p.sh. aspektet vijuese:

- Kërkesa që vendet anëtare të miratojnë rregulla transparente dhe të qasshme për publikun për mënyrën e përcaktimit të koston së ngrohjes dhe ftohjes te ndërtesat shumëbanesore ose ndërtesat me destinacion të shumëfishtë, të cilat furnizohen me ngrohje/ftohje qendrore ose

në të cilat dominojnë sistemet vetjake të ngrohjes/ftohjes me qëllim të sigurimit të transparencës dhe llogaridhënies lidhur me konsumin individual (Direktiva 2012/27/EU për EE). Në kuadër të rregullave të tilla duhet të sqarohet mënyra e matjes përveç energjisë së konsumuar për ngrohje/ftohje të apartamenteve, edhe energjia e konsumuar për ngrohje të ujit sanitar dhe energjia e konsumuar në hapësira të përbashkëta siç janë: shkallët dhe korridoret;

- Afati që matësit e instaluar pas 30 tetorit 2023 duhet të jenë njehsorë inteligjent ndërsa zëvendësimi i matësve tashmë të instaluar me ata inteligjent të përfundoj deri më 1 janar 2030 (Direktiva 2012/27/EU për EE);
- Nevoja që vendet anëtare për ndërtesat e reja dhe ato të cilat janë subjekt i një ndonjë renovimi të madh të specifikojnë sasi të minimale të energjisë nga BRE-të, brenda kodeve të ndërtimit (Direktiva (EU) 2018/2001 për BRE-të).

1.6. Pema e problemit

Bazuar në analizën pararendëse lidhur me rëndësinë e energjisë termike për sistemin energjetik të vendit, orientimet strategjike, zhvillimin institucional, kornizën aktuale ligjore dhe gjendjen aktuale të sektorit të energjisë termike, duke pasur parasysh edhe nivelin e harmonizimit të dispozitave përkatëse ligjore me ato të BE-së, si dhe rekomandimet/udhëzimet/informatat nga Grupi Punues (GP), në vazhdim është përshkruar i tërë problemi. Fillimisht, në tabelën pasuese është paraqitur i tërë problemi në formë të “pemës së problemit”, kurse në vazhdim të dokumentit është bërë edhe përshkrimi më i detajuar problemit kryesor, shkaqeve, dhe efekteve të cilat do të paraqiteshin nëse problemi i tillë nuk adresohet.

Tabela 3: Pema e problemit përkatësisht efektet, problemi kryesor dhe shkaqet

Efektet	1. Trajtim joeficient dhe joadekuat i energjisë termike brenda kornizës ligjore ekzistuese; 2. Harmonizimi i pamjaftueshëm i disa aspekteve relevante të energjisë termike në dispozitat ekzistuese ligjore krahasuar me ato që rezultojnë nga direktivat e BE-së; 3. Kufizimi i mundësisë për promovimin e konkurrencës në sektorin e energjisë termike, pengesat në zgjerimin e kapaciteteve furnizuese, reduktimi i mundësive për menaxhimin më të mirë të rrjetit primar dhe zvogëlimin e humbjeve termike, zvogëlimi i mundësisë për qasje të barabartë në furnizimin me energjinë termike dhe rrezikimi i mundësive për arritjen e objektivave strategjike lidhur me EE, BRE-të dhe uljen e emetimeve në nivel kombëtar; 4. Kufizimi i mundësisë për shërbime cilësore si rezultat i përgjegjësisë jo të definuara sa duhet lidhur me mirëmbajtjen e rrjetit sekondar, vazhdimi i kontesteve gjyqësore që rezultojnë nga situatat e tilla të padefinuara dhe limitimi i mundësisë për parandalimin e abuzimeve/lëshimeve përkatëse.
Problemi Kryesor	Ligji aktual për energjinë termike është jo i plotë, nuk adreson nevojën për promovimin e burimeve alternative të energjisë termike dhe zgjerimin e kapaciteteve, si dhe nuk përfshin trajtimin e aspekteve tjera të rëndësishme për zhvillimin e sektorit të energjisë termike dhe harmonizimit të legjislacionit përkatës me atë të BE-së.

Shkaqet	1. Aspekte të ndryshme të energjisë termike janë trajtuar ndaras në katër (4) ligje tjera të cilat kanë të bëjnë me energjinë termike, Efiçencën e Energjisë (EE), Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë (BRE) dhe performancën energjetike të ndërtesave; 2. Disa aspekte të trajtuara brenda direktiva të BE-së, si ato lidhur me rregullat e përcaktimit të kostos së ngrohjes të ndërtesat me shumë apartamente ose ndërtesat me destinacion të shumëfishte, planifikimin me kohë të ngrohjes së ujit sanitar për ndërtesat me shumë apartamente, minimumin e energjisë nga BRE-të, në ndërtesat e reja/ndërtesat që janë subjekt i ndonjë renovimi të madh dhe afatin zbatimit të njehsorëve inteligjent, nuk janë adresuar brenda kornizës ligjore të Republikës së Kosovës; 3. Aspekte relevante lidhur me funksionimin e sistemit të energjisë termike siç janë ato lidhur me llojin dhe strukturën e entiteteve operuese në tregun e energjisë termike, mënyrën e menaxhimit, shtrirjes dhe mirëmbajtjes së rrjetit, rolin e autoriteteve komunale për zhvillimin e sektorit nuk janë trajtuar në ligjin ekzistues për energjinë termike; 4. Korniza ligjore ekzistuese nuk ofron kornizën e nevojshme lidhur me përgjegjësinë dhe të drejtën e mirëmbajtjes së rrjetit sekondar, evitimin me kohë të avarive të ndryshme dhe mënyrën e sanksionimit të abuzimeve/lëshimeve të mundshme.
----------------	--

1.6.1. Problemi kryesor

Shfrytëzimi ekstensiv i energjisë elektrike për mbulimin e nevojave lidhur me energjinë termike me qëllim të plotësimit të kërkesave për ngrohje respektivisht për ftohje në sektorin rezidencial e pjesërisht edhe atë të shërbimeve, paraqet një ndër sfidat kryesore për sistemin energjetik të vendit. Si rezultat i përvojës pozitive nga realizimi i projektit të kogjenerimit me Termocentralin “Kosova B” në Prishtinë, kompania e Ngrohjes Qendrore (NQ) Termokos ka planifikuar dhe është në fazën e realizimit të projektit për dyfishimin e kapaciteteve ekzistuese të kogjenerimit. Po ashtu, Termokosit parashihet t’i rritet kapaciteti për energji termike edhe 50 MW duke shfrytëzuar si burim primar energjinë solare. Për më temper Republika e Kosovës ka ndërmarrë iniciativën dhe është në fazën përmblylëse të studimit të fizibilitetit lidhur me zhvillimin e njësive të bashkëprodhimit edhe në tetë (8) komuna tjera të Republikës së Kosovës. Realizimi me sukses i një plani të tillë, do të reflektohej në përmirësim të dukshëm të furnizimit me ngrohje, por edhe në zvogëlimin domethënës të ndotjes mjedisore. Në këtë mënyrë vendi do të mund të raportonte progres konkret në Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë (SKE), dhe do të konfirmonte përkushtimin në raport me Deklaratën e Sofjes lidhur me Agjendën e Gjellbër (AGj), në fushën e përmirësimit të Efiçencës së Energjisë (EE), në sektorin e ngrohjes dhe të zvogëlimit të ndotjes mjedisore. Megjithatë si sfida serioze, në realizimin e nismave të tilla, mund të paraqitet korniza ligjore e tejkaluar. Kjo arsyetohet me faktin që ligji aktual për energjinë termike i miratuar në vitin 2015 nuk i është nënshtruar asnjë përditësimit i cili do të ofronte bazën e nevojshme ligjore për mbështetjen e projekteve të cekura. Sidomos, problematik është zhvillimi i sektorit të energjisë termike nëpër komuna, meqë ligji aktual nuk ofron kornizën e nevojshme ligjore për ndërveprimin e komunave, institucioneve qendrore dhe operatorëve përkatës të energjisë termike.

Problem në vete paraqet edhe trajtimi i mangët në ligjin ekzistues i disa aspekteve tejet të rëndësishme lidhur me adaptimet/ndryshimet e instalimit sekondar, mirëmbajtjen dhe sanimin e avarive, si dhe lidhur me procesin e matjes dhe faturimit të konsumatorëve. Si rezultati i zbrazëtirave të tilla, shpesh paraqiten konteste ndërmjet konsumatorëve dhe operatorëve, zgjidhja e të cilave kërkon resurse, kohë dhe shpenzime të panevojshme.

Në kuadër të problemit kryesor përfshihet edhe ndikimi negativ i kornizës ligjore jo të përditësuar në implementimin e planeve zhvillimore të vendit në sektorin e energjisë termike për nevoja të ngrohjes/ftohjes për shkak të adresimit joadekuat të aspekteve specifike si ato lidhur me gjenerimin, shpërndarjen, furnizimin dhe operatorët e energjisë termike, rregullat e rrjetit, masat ndëshkimore etj.

1.6.2. Shkaqet

Korniza ligjore e Republikës së Kosovës lidhur me energjinë termike, përmban elemente dhe aspekte të cilat janë të përfshira në ligjin për energjinë termike por një pjesë e konsiderueshme e tyre edhe në tri (3) ligje tjera e të cilat paraqesin transpozim të direktivave përkatëse të BE-së, në fushën e Efiçencës së Energjisë (EE), Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë (BRE) dhe performancës energjetike të ndërtesave. Edhe pse korniza e tillë ligjore ka siguruar më masën më të madhe harmonizimin e direktivave përkatëse të Republikës së Kosovës me ato të BE-së, trajtimi në katër (4) dokumente të ndryshme ka rezultuar në situatën e cila karakterizohet me trajtim të fragmentizuar të dimensioneve të ndryshme të energjisë termike në dokumente të ndryshme. Për pasojë, procesi i implementimit mund të përcillet me paqartësi dhe dilema të cilat në anën tjetër do të manifestoheshin me efekte negative edhe në fazën monitorimit dhe raportimit lidhur me nivelin e zbatimit.

Ligji aktual për energjinë termike është miratuar në vitin 2015 dhe në ndërkohë nuk ka pasur ndonjë plotësim ndryshim të tij, edhe pse në raste të caktuara, ligjet tjera të aprovuara më vonë i referohen dispozitave të ligjit për energji termike por të cilat dispozita për shkak të mungesë së përditësimit të ligjit, nuk ofrojnë një rregullim të tillë. Rrjedhimisht disa aspekte relevante për rregullimin e këtij sektori nuk janë adresuar në nivelin e duhur. Në këtë kuadër mund të përfshihet po ashtu, edhe pse në pak raste, transpozimi i mangët i disa dimensioneve specifike të direktivave të BE-së, në legjislacionin vendor.

Përveç mangësive të cekura më sipër, ligji aktual për energjinë termike nuk ofron kornizën e nevojshme rregulluese e cila do të ishte në funksion të zhvillimeve pozitive të dekadës së fundit në këtë sektor e që janë të ndërlidhura me zgjerimin e kapaciteteve prodhuese, nevojën për promovimin e konkurrencës në sektorin e energjisë termike, nevojën e bashkëpunimit aktiv të autoriteteve komunale lidhur planifikimin e kapaciteteve të reja, zgjerimin e rrjetit dhe për promovimin e teknologjive dhe burimeve alternative për prodhimin e energjisë termike.

Për arsye të ndryshme objektive dhe subjektive p.sh. mungesa e përvojës në zbatim dhe pamundësia e parashikimit të situatave problematike, etj., ligji aktual nuk ofron kornizë të mjaftueshme rregulluese për procesin e matjes, faturimit dhe informimit adekuat të konsumatorëve. Po ashtu ligji aktual nuk ofron kornizën e nevojshme ligjore lidhur me përgjegjësinë, mënyrën e mirëmbajtjes dhe koston përkatëse të rrjetit sekondar në rastin e

ndërtesave me shumë apartamente. Në ligjin aktual nuk ekzistojnë dispozita të cilat do ta promovonin ngrohjen e ujit sanitar nëpërmjet sistemeve të Ngrohjes Qendrore (NQ) p.sh. duke paraparë nevojën e planifikimit me kohë të rrjetit sekondar të ujit sanitar sidomos në ndërtesat me shumë apartamente, si dhe duke paraparë mënyra transparente të majtës së energjisë së konsumuar për nevoja të tilla. Pavarësisht rritjes së nevojës për ftohje të hapësirave në vitet e fundit, ligji aktual për energjinë termike nuk ofron kornizën mbështetëse për promovimin e sistemeve të ftohjes qendrore nëpërmjet aplikimit të sistemeve eficientë siç janë: pompat termike, qoftë fillimisht edhe në formë të pilot projekteve.

1.6.3. Efektet

Nëse ligji aktual për energjinë termike nuk plotësohet/ndryshohet në mënyrë që të reflektoj zhvillimet e fundit në këtë sektor, si në rrafshin vendor ashtu edhe në rrafshin e politikave të BE-së, efektet negative do të kishin karakter frenues në trendin aktual pozitiv të zhvillimit të këtij sektori. Në këtë mënyrë do të mund të rrezikohej edhe implementimi dhe realizimi i objektivave të parapara në Strategjinë e Energjisë së Republikës së Kosovës për periudhën 2022-2031. Në këtë kontekst si efekte negative mund të ceken:

- Zbatimi i mangët dhe joefikas i dispozitave të ndryshme ligjore të shpërndara nëpër dokumente të ndryshme, monitorimi i vështirësuar dhe raportim i fragmentuar;
- Harmonizim jo i plotë e bazës ligjore me atë të BE-së, lidhur me energjinë termike për ngrohje/ ujë sanitar të brenda hapësirave specifike, limiteve kohore lidhur me instalimin e njehsorëve inteligjentë, dhe përmasave të promovimit të BRE-ve, brenda kodeve të ndërtimit
- Rrezikimi i realizimit të objektivave zhvillimore dhe kufizimi i përfitimeve nga zbatimi i projekteve në realizim e sipër e në këtë mënyrë edhe zvogëlimi i mundësive për një progres domethënës në dekarbonizimin e pjesës urbane të sektorit të ngrohjes/ftohjes;
- Shfrytëzimi i pamjaftueshëm dhe joeficient i burimeve ekzistuese, në veçanti atyre të ripërtërtitshme të energjisë, kufizimi i mundësisë për aplikimin e teknologjive të reja dhe alternative prodhuese, kufizimi i alternativave për rritjen e sigurisë dhe qëndrueshmërisë së furnizimit, limitimi i mundësive për adresimin me kohë dhe në mënyrë kompetente të pengesave lidhur me zgjerimin e kapaciteteve prodhuese dhe ndërtimin e kapaciteteve të reja;
- Zvogëlim i mundësisë për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe për rregullimin e çmimit të furnizimit për shkak të mos ofrimit të mundësisë për hapjen e tregut dhe promovimin e konkurrencës, si dhe për shkak të mirëmbajtjes jo adekuate dhe me kohë të rrjetit sekondar si rezultat i mosdefinimit të përgjegjësisë, formës së mirëmbajtjes dhe kostove përkatëse;
- Vazhdimi i konsumit të energjisë elektrike për ngrohje të ujit sanitar për shkak të mosplanifikimit me kohë të shfrytëzimit të energjisë termike për nevoja të tilla.

1.7. Krahاسimi me vendet e tjera

Në mesin e vendeve të rajonit të cilat disponojnë sisteme të prodhimit dhe furnizimit me energji elektrike bëjnë pjesë: Kosova, Kroacia, Maqedonia e Veriut, Serbia dhe Bosnja e Hercegovina²⁰. Mali i Zi dhe Shqipëria nuk disponojnë kapacitete gjeneruese lidhur me energjinë termike, por janë në realizim e sipër të nga një projekti të tillë^{21,22,23}. Për nevoja të analizës aktuale, në vazhdim do përshkruhet gjendja në Maqedoninë e Veriut dhe në Kroaci.

Maqedonia e Veriut- Korniza ligjore në fushën e energjisë në këtë shtet përbëhet nga dy ligje dhe aktet përkatëse nënligjore. Ligjet e tilla janë:

- Ligji i Energjetikës²⁴
- Ligji për Eficiencë të Energjisë²⁵

Ligji i Energjetikës paraqet ligjin bazik dhe gjithëpërfshirës në kuptimin e aspekteve që rregullon. Në këtë ligj ndër të tjera janë paraparë dispozita për rregullimin e çështjeve që kanë të bëjnë me energjinë elektrike, energjinë termike dhe ato lidhur me Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë (BRE). Plotësim/ndryshimi i fundit i këtij ligji është bërë në vitin 2022.

Ligji për Eficiencë të Energjisë (EE) është miratuar në vitin 2020, me qëllim të transpozimit të direktivave të BE-së, lidhur me Eficiencën e Energjisë (EE), performancën energjetike të ndërtesave, etiketimin e produkteve energjetike etj.

Detajet e çështjeve relevante që lidhen me energjinë elektrike, energjinë termike, Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë (BRE), performancën energjetike të ndërtesave etj. Maqedonia e Veriut i ka rregulluar nëpërmjet akteve përkatëse nënligjore. Aktet nënligjore lidhur me energjinë termike adresojnë çështjet që kanë të bëjnë me rregullat e çmimit, sistemin tarifor, rregullat e furnizimit, rregullat e cilësisë dhe rregullat e rrjetit²⁶.

Një formë e tillë e rregullimit nuk është tërësisht kompatible me kërkesat e Traktatit të Energjisë (TE). Raporti përkatës i fundit lidhur me implementimin e politikave energjetike²⁷ kërkon nga Maqedonia e Veriut aprovimin e Ligjit për Burimet e Ripërtëritshme dhe amendamentimin e Ligjit për Eficiencën e Energjisë (EE). Lidhur me energjinë termike, ky raport specifikon që mungojnë masat për integrimin e burimeve të ripërtëritshme në sistemin e Ngrohjes Qendrore (NQ) të Shkupit dhe që nuk është duke u implementuar faturimi bazuar në konsumin e energjisë termike.

²⁰ <https://bankwatch.org/blog/district-heating-in-the-western-balkans-we-need-clean-modern-heating-that-works-for-everyone-for-the-long-term>

²¹ https://www.energy-community.org/dam/jcr:77a9cb08-a6bd-4479-9c05-0cbb8b10b015/EnC_IR2023_Montenegro.pdf

²² https://www.energy-community.org/dam/jcr:1e419b0f-0832-421f-82aa-b66f6a19daa6/CARi_EBRD_0222.pdf

²³ https://bankwatch.org/wp-content/uploads/2023/10/2023_10_16_Scaling-up-investments-in-the-decarbonisation-of-district-heating.pdf

²⁴ https://www.erc.org.mk/odluki/Izmeni%20na%20Zakon%20za%20energetika_236%2022_AL.pdf

²⁵ https://www.erc.org.mk/odluki/22Zakon_ener_efikasnost_36_2020_AL.pdf

²⁶ https://www.erc.org.mk/page_al.aspx?id=316

²⁷ https://www.energy-community.org/dam/jcr:f0c98e19-9500-4b08-981e-c41a1d7827fe/EnC_IR2023_North_Macedonia.pdf

Bazuar në gjendjen e prezantuar për Maqedoninë e Veriut, lidhur me kornizën ligjore mund të thuhet që Republika e Kosovës qëndron më mirë, meqë spektri i dimensioneve energjetike të cilat rregullohen me ligj është dukshëm më i gjerë, e në këtë mënyrë edhe transpozimi i aspekteve relevante nga Direktivat e BE-së është më i plotë.

Kroacia- Si shtet anëtar i Bashkimit Evropian (BE) por që mund të konsiderohet edhe shtet i rajonit, sistemi energjetik i Kroacisë karakterizohet me një kornizë të konsoliduar dhe gjithëpërfshirëse ligjore. Korniza e tillë përbëhet nga ligjet bazike të përditësuara dhe aktet e shumta nënligjore. Aktet ekzistuese ligjore i dedikohen në mënyrë të veçantë çdonjërit prej dimensioneve të politikave aktuale energjetike dhe në këtë mënyrë ofrojnë bazën moderne ligjore për adresimin e tyre në vijë me politikat e Bashkimit Evropian (BE) dhe konform nevojave të sistemit energjetik të vendit. Lista e ligjeve të tilla është si vijon²⁸:

- Ligji për Energjinë;
- Ligji për Tregun e Energjisë Elektrike;
- Ligji për Tregun e Gazit;
- Ligji për Terminalët e Gazit Natyror të Lëngëzuar (GNL);
- Ligji për Tregun e Energjisë Termike;
- Ligji për Tregun e Naftës dhe Derivateve të Naftës;
- Ligji për Bio-derivatet e Transportit;
- Ligji për Rregullimin e Veprimtarive Energjetike;
- Ligji për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë (BRE) dhe Kogjenerimit shumë eficient;
- Ligji për Eficiencë të Energjisë (EE).

Çdonjëri prej këtyre ligjeve është i plotësuar me aktet përkatëse nënligjore. Për shkak të rëndësisë lidhur me të fokusin e dokumentit aktual, në vazhdim janë prezantuar disa aspekte relevante të cilat e karakterizojnë bazën ligjore që rregullon tregun e energjisë termike.

Spektori i energjisë termike në Kroaci është mjaft i zhvilluar dhe luan një rol domethënës në stabilitetin energjetik të vendit. Energjia termike e prodhuar në sistemet e Ngrohjes Qendrore (NQ), përbën rreth dhjetë për qind (10 %) të energjisë totale termike të shfrytëzuar në këtë shtet²⁹ dhe përputhet me mesataren e tillë në nivel të Bashkimit Evropian³⁰. Edhe pse një version i ligjit për energjinë termike në Kroaci daton qysh nga viti 2005, ligji për tregun e energjisë termike me emërtimin aktual për herë të parë është miratuar në vitin 2013, ndërsa deri në versionin e fundit të vitit 2019 ka kaluar nëpër pesë (5) plotësime/ndryshime³¹.

Në funksion të implementimit të ligjit për tregun e energjisë termike janë aprovuar gjithsej tetë (8) akte nënligjore³². Nëpërmjet akteve të tilla nënligjore ndër të tjera bëhet rregullimi specifik i

²⁸ <https://www.hera.hr/hr/html/zakoni.html>

²⁹ <https://keepwarmeuropa.eu/countries-in-focus/croatia/english/#:~:text=Current%20district%20heating%20systems%20in,through%20combined%20heat%20and%20power>

³⁰ <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32018L2001>

³¹ <https://www.zakon.hr/z/606/Zakon-o-tr%C5%BEi%C5%A1tu-toplinske-energije>

³² <https://www.iusinfo.hr/zakonodavstvo/pretraga/podzakonski-propisi/ZA2013B80A1655>

aspekteve që kanë të bëjnë me analizën e kostove dhe benefitit, mënyrën e përcaktimit të tarifës për kyçje në rrjetin e shpërndarjes së ngrohjes dhe për rritjen e fuqisë së kyçjes, mënyrën e shpërndarjes dhe llogaritjes së kostove për energjinë termike të dorëzuar, kushtet e përgjithshme për furnizimin me energji termike, rregullat e rrjetit për shpërndarjen e energjisë termike, kushtet e përgjithshme për shpërndarjen e energjisë termike, lartësinë dhe mënyrën e pagesës së tarifës së koncesionit për shpërndarjen e energjisë termike dhe koncesionit për ndërtimin e objekteve energjetike për shpërndarjen e energjisë termike.

Analiza e prezantuar e bazës ligjore të Kroacisë dëshmon që ky shtet ka të miratuara dhe zbaton ligjet përkatëse për të gjitha dimensionet relevante të sektorit të energjisë. Të gjitha ligjet e tilla janë të shoqëruara me akte përkatëse nënligjore, gjë që bën të mundur rregullimin e sektorit të energjisë në vijë me të gjitha orientimet dhe nismat strategjike të BE-së. Në anën tjetër, Kosova përkundër progresit të dëshmuar vit pas viti, ende ka një kornizë ligjore të pakompletuar sa i përket sektorit të energjisë. Edhe në rastin e përditësimit me kohë të ligjeve përkatëse respektivisht miratimit të ligjeve të reja siç është p.sh.: ligjit për promovimin e BRE-ve, dhe ligjit për performancën energjetike në ndërtesa, hartimi i akteve përkatëse nënligjore do të marrë kohë të konsiderueshme. Në anën tjetër, baza ligjore që rregullon sektorin e energjisë termike në Kosovë është dukshëm më e varfër dhe e tejkaluar krahasuar me bazën ligjore të Kroacisë. Një gjendje e tillë ka rezultuar nga mungesa e përditësimit të ligjit të energjisë termike që nga viti 2015, për derisa Kroacia ka qenë shumë aktive në përditësimin bazës përkatëse ligjore dhe në këtë mënyrë ka promovuar në mënyrë aktive zhvillimin e mëtejshëm të këtij sektori.

Kapitulli 2: Qëllimi dhe Objektivat

Qëllimi i koncept - dokumentit aktual është krijimi i një baze ligjore gjithëpërfshirëse, moderne, dhe në pajtueshmëri me politikat e BE-së, e cila adreson sfidat aktuale dhe nevojat në të ardhmen të sektorit të energjisë termike në Republikën e Kosovës. Në këtë kontekst, synohet rregullimi i aspekteve vijuese:

- Krijimi i bazës së re ligjore me qëllim të rregullimit efektiv të aspektit të prodhimit, shpërndarjes dhe furnizimit, si dhe adresimit të qartë të përgjegjësisë së operatorëve në sektorin e energjisë termike gjë që do të ndikonte në rritjen e besueshmërisë së furnizimit dhe transparencës brenda sektorit;
- Krijimi i bazës ligjore legale të qëndrueshme për mbështetjen e zhvillimit të sektorit të energjisë termike me fokus në ngritjen e njësive të reja të kogjenerimit duke u bazuar në shfrytëzimin e BRE-ve, diversifikimin e burimeve dhe teknologjisë inovative gjë që praktikisht do të rezultonte në zvogëlimin e varësisë së Kosovës nga linjit dhe do të lehtësonte dekarbonizimin e sektorit të energjisë siç parasheh Objektivi 2 i Strategjisë së Energjisë i Republikës së Kosovës për periudhën 2022-2031;
- Ndërtimi i bazës ligjore të Republikës së Kosovë lidhur me energjinë termike në përputhje të plotë me direktivat e fundit të BE-së, dhe standardet ndërkombëtare për të përmirësuar Eficiencën e Energjisë (EE) dhe për të zvogëluar ndikimet mjedisore. Kjo do të demonstronte përkushtimin e Republikës së Kosovës ndaj detyrimeve ndërkombëtare në sektorin e energjisë dhe në këtë mënyrë do të rriste reputacionin e saj dhe mundësinë e tërheqjes së investimeve të gjelbra;
- Mënjanimi i paqartësive ekzistuese ligjore me qëllim të rritjes së nivelit të zbatimit bazës ligjore lidhur me energjinë termike. Në këtë mënyrë do të përmirësohej procesi i monitorimit dhe raportimit, to të rritej transparenca dhe do të krijoheshin mekanizmat për trajtimin efektiv të mosmarrëveshjeve ndërmjet konsumatorëve dhe operatorëve, duke siguruar zgjidhje brenda afateve optimale dhe në mënyrë korrekte të çështjeve kontestuese;
- Krijimi i kornizës rregullatore të qartë, transparente për matje, faturim dhe komunikim me konsumatorët. Kjo do të reduktojë mosmarrëveshjet, do të sigurojë trajtim të drejtë dhe do të përmirësonte nivelin e kënaqësisë dhe besueshmërisë së konsumatorëve me cilësinë e shërbimit të ofruar lidhur me energjinë termike;
- Krijimi i bazës ligjore e cila në mënyrë efektive do të mbështeste futjen në zbatim të teknologjive të reja dhe zgjidhjeve alternative energjetike dhe në këtë mënyrë do të ndikonte në rritjen e sigurinë dhe besueshmërinë së furnizimit me energji termike. Baza e tillë ligjore praktikisht do të rezultonte në një sektor eficient, mirë të rregulluar dhe të strukturuar në formën e cila do mundësonte përmbushjen e kërkesave aktuale dhe në të ardhmen për energji termike;
- Siç është prezantuar në vazhdim, qëllimi i përshkruar konsiston me objektivat strategjike sipas Strategjisë së Energjisë të Republikës së Kosovës për periudhën 2022-2031 dhe objektivat specifike përkatëse në funksion të arritjes së objektivave strategjike.

Objektivat Strategjike:

- Promovimi i sistemeve më eficiente dhe më të pastra për ngrohje individuale dhe/ose qendrore duke marrë parasysh BRE-të, p.sh.: biomasën, ngrohjen gjeotermike dhe pompat termike (Objektivi Strategjik 2: Dekarbonizimi dhe promovimi i energjisë së ripërtëritshme, Strategjia e Energjisë për periudhën 2022-2031);
- Diversifikimi i teknologjisë të sistemit ekzistues të Ngrohjes Qendrore (NQ) të Prishtinës deri në vitin 2025, në mënyrë që të përfshihet ngrohja solare prej së paku 50 MW_{th} (Objektivi Strategjik 2: Dekarbonizimi dhe promovimi i energjisë së ripërtëritshme, Strategjia e Energjisë për periudhën 2022-2031);
- Përkrahja e teknologjive energji-eficiente dhe miqësore ndaj mjedisit siç janë: pompat termike dhe sistemet solar termike (Objektivi Strategjik 3: Rritja e Eficiencës së Energjisë (EE), Strategjia e Energjisë për periudhën 2022-2031);
- Promovimi i sistemeve eficiente të ngrohjes qendrore nëpërmjet dyfishimit të kapacitetit ekzistues të kogjenerimit (Objektivi Strategjik 3: Rritja e Eficiencës së Energjisë (EE), Strategjia e Energjisë për periudhën 2022-2031).

Objektivat specifike:

- Hartimi i ligjit të ri për energjinë termike si dokument kryesor ligjor që integron dhe zëvendëson dispozitat e fragmentuara nëpër dokumente të shumta, duke vendosur fokusin në energjinë termike për ngrohje/ftohje, si dhe duke siguruar qartësi dhe trajtim adekuat të aspekteve lidhur rregullim e prodhimit, shpërndarjen dhe furnizimin e energjisë termike;
- Vendosja e dispozitave ligjore që mbështesin zgjerimin e kapaciteteve të bashkëprodhimit dhe integrimin e Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë (BRE), si dhe teknologjive alternative dhe të dëshmuara të energjisë me qëllim të uljes së varësisë nga energjia elektrike;
- Krijimi i kornizës së qartë për matjen, faturimin dhe informimin e konsumatorëve në mënyrë specifike lidhur me energjinë termike për ngrohje/ftohje;
- Krijimi i një kuadri ligjor që përcakton qartë rolet dhe përgjegjësitë e autoriteteve komunale, institucioneve qendrore dhe operatorëve të energjisë termike për të lehtësuar koordinimin dhe bashkërendimin më të mirë të aktiviteteve lidhur me planifikimin dhe menaxhimin e investimeve në fushën e energjisë termike;
- Qartësimin dhe avancimin e mëtejshëm të mekanizmave të monitorimit dhe raportimit, për të garantuar transparencë, monitorim të progresit dhe adresim eficient të çdo kontesti, duke përmirësuar kështu qeverisjen dhe llogaridhënien e përgjithshme brenda sektorit.

Me arritjen e këtyre objektivave strategjike dhe specifike, ligji i ri për energjinë termike do të adresojë kufizimet e kornizës aktuale ligjore, do të mbështesë zhvillimin e sektorit dhe do të kontribuojë në qëllimet më të gjera energjetike dhe mjedisore të Republikës së Kosovës. Duke

pasur parasysh që energjia termike është një formë specifike e energjisë, e cila duhet te trajtohet edhe në kontekstin e përmirësimit të Efiçencës së Energjisë (EE), dhe integritetit të BRE-ve, objektivat e shtjelluar më lartë janë në vijë me dokumentet tjera ekzistuese të Qeverisë së Republikës së Kosovës (QRK) përkatësisht të Republikës së Kosovës. Një ndërlidhje e tillë është prezantuar në tabelën vijuese.

Tabela 4: Objektivat përkatëse të Qeverisë së Republikës së Kosovës (QRK)

Objektivi relevant	Emri i dokumentit përkatës të planifikimit (burimi)
• Promovimin e sistemeve më efiçiente dhe më të pastra për ngrohje individuale dhe/ose qendrore duke marrë parasysh BRE-të; • Diversifikimi i teknologjisë së sistemit ekzistues të Ngrohjes Qendrore (NQ), në Prishtinë nëpërmjet ngrohjes solare; • Përkrahja e teknologjive energji-efiçiente dhe miqësore ndaj mjedisit siç janë: pompat termike dhe sistemet solar termike; • Promovimi i sistemeve efiçiente të Ngrohjes Qendrore (NQ), nëpërmjet dyfishimit të kapacitetit ekzistues të kogjenerimit.	Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës për periudhën 2022-2031
Promovimi i përdorimit të energjisë së ripërtëritshme për ngrohje	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve për periudhën 2025-2027
Lista e prioriteteve, Prioriteti 2.2. Angazhimi drejt përmbushjes së caqeve të Efiçencës së Energjisë (EE), dhe energjisë së ripërtëritshme.	Agjenda e Reformës Evropiane (ERA 2)
Masa e reformës 5. Zhvillimi i politikave për Efiçencën e Energjisë (EE) dhe Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë (BRE) në funksion të tranzicionit të gjelbër.	Programi për Reforma në Ekonomi (PRE) për periudhën 2022-2024

Kapitulli 3: Opsionet

Ashtu siç u analizua në kuadër të përshkrimit të gjendjes aktuale (Seksioni 1.6) dhe të problemit kryesor (Seksioni 1.7.1.), sektori i energjisë termike në Republikën e Kosovës për një kohë të gjatë është rregulluar dhe menaxhuar bazuar në ligjin për energji termike të vitit 2015 dhe në dispozita të shpërndara në dokumente tjera ligjore. Edhe pse ligji ekzistues për nergjienë termike është hartuar në funksion të trajtimit specifik të energjisë termike, i njëjti nuk është plotësuar/ndryshuar në ndërkohë për të adresuar kërkesat e dekadës së fundit të cilat rezultojnë qoftë nga Direktivat e BE-së, qoftë nga përvoja e zhvillimeve konkrete brenda këtij sektori. Për pasojë, baza e tillë ligjore nuk është e mjaftueshme për akomodimin e objektivave aktuale të sektorit lidhur me prodhimin, diversifikimin e burimeve, dhe përmirësimin e efijencës nëpërmjet zgjerimit të kogjenerimit të energjisë. Po ashtu, situata e tillë manifestohet me paqartësi dhe rrethana jo të definuara të cilat reflektohen në cilësinë e monitorimit, raportimit dhe menaxhimit të këtij sektori. Në kontekstin e gjendjes së përshkruar të bazës ligjore për energjisë termike dhe nga aspekti i mënyrës së adresimit të saj, në parim mund të përzgjidhet njëra nga tri (3) mënyrat ose opsionet e shtjelluara në vazhdim.

Opsioni 1- Ruajtja e Status quos (asnjë ndryshim)

Përcaktimi për këtë opsion, nënkupton vazhdimi i gjendjes aktuale, pa bërë asnjë ndryshim ose plotësim të bazës ligjore. Konkretisht, në opsion i tillë nënkupton që sektori i energjisë termike do të vazhdon të trajtohet nëpërmjet ligjit ekzistues për energjinë termike dhe tri (3) ligjeve aktuale lidhur me Efijencën e Energjisë (EE), Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë (BRE) dhe performancën energjetike të ndërtesave. Për shkak të kufizimeve të ligjit për energjinë termike lidhur me adresimin e mënyrës së matjes dhe faturimit në raste të caktuara, mënyrës së shfrytëzimit të energjisë termike për ngrohjen e ujit sanitar, paqartësive lidhur me mënyrën e trajtimit të kontesteve të ndryshme me konsumatorët, mënyrës dhe nivelit të kontributit të autoriteteve lokale për zgjerimin e kapacitete të kogjenerimit, mundësinë e përfshirjes më të gjerë të BRE-ve, në sektorin e energjisë termike, aplikimit të teknologjive të reja, diversifikimit të burimeve por edhe për shkak të nevojës për harmonizim më të mirë të bazës ligjore me atë të BE-së, korniza aktuale ligjore që rregullon sektorin e energjisë termike duhet të plotësohet, përditësohet dhe kompletohet në mënyrë domethënëse. Prandaj përcaktimi për opsionin e ruajtjes së Status quos do të kishte për pasojë vazhdimin dhe thellimin e problemeve tashmë të cekura të cilat e karakterizojnë këtë sektor, do të frenonte zhvillimet aktuale dhe do të rrezikonte përmbushjen e objektivave strategjike lidhur me këtë sektor në Strategjinë e Energjisë për periudhën 2022-2031. Në terma praktik kjo do të nënkuptonte vazhdimin e përdorimit ekstensiv të energjisë elektrike për nevoja të ngrohjes, vazhdimin e varësisë së madhe nga linjiti, vazhdimin e emetimeve të CO₂ dhe ndotjes së mjedisit, pakënaqësisë së qytetarëve me shërbimet e ofruara dhe rrezikimin e përmbushjes së obligimeve si shtet në raport me institucionet ndërkombëtare. Rrjedhimisht, bazuar në argumentet e ofruara, Grupi Punues (GP) nuk rekomandon përzgjedhjen e këtij opsioni.

Opsioni 2

Përzgjedhja e këtij opsioni nënkupton që dispozitat përkatëse të ligjit ekzistues për energjinë termike të plotësohen ose ndryshohen dhe të shtohen dispozita të reja, me qëllim të adresimit të

mangësive të evidentuara si pengesa për zhvillimin e sektorit. Në rast të përcaktimit për një opsion të tillë, plotësim/ndryshimet e nevojshme mund të jenë të kategorive vijuese:

- Rregullimi dhe plotësimi i dispozitave ekzistuese në ligjin aktual për energjinë termike;
- Përfshirja e dispozitave të reja që nuk janë të përfshira në asnjërën prej ligjeve tjera lidhur me energjinë;
- Përfshirja e dispozitave si plotësim i dispozitave ekzistuese në ligjet tjera të energjisë.

Nëse të gjitha plotësim/ndryshimet e nevojshme kryhen me sukses, ligji i përshtatur, formalisht, do të ofronte bazën për të cilën ka nevojë sektori i energjisë. Mirëpo, në rastin e tillë vetë procesi i plotësim/ndryshimit do të ishte i komplikuar ndërsa zbatimi i tij në praktikë jo i lehtë. Kjo për faktin se:

- Numri i dispozitave ekzistuese që duhet të rregullohen dhe plotësohen është i konsiderueshëm;
- Procesi i plotësim/ndryshimit do të kërkonte përfshirjen dhe bashkëpunimin aktiv të shumë institucioneve të cilat janë sponsor të ligjeve tjera të energjisë, dispozitat e të cilave duhet të plotësohen/ndryshohen;
- Konfuzioni lidhur me ligjet të cilave duhet referuar, në fazën e zbatimit praktik të aspekteve të ndryshme që lidhen me energjinë termike do të vazhdonte të mbetej faktor pengues për zbatimin e tij dhe të vështirësonte monitorimin dhe raportimin lidhur me nivelin e zbatimit;
- Promovimi i përfshirjes më të gjerë të BRE-ve, dhe teknologjive tjera të reja në sektorin e energjisë termike, është më pak efektiv krahasuar me rastin kur hartohet ligji i ri.

Rrjedhimisht, Grupi Punues (GP) konsideron që institucionet nuk do të duhej të përcaktoheshin për këtë opsion, përveç nëse ekzistojnë arsye konkrete të cilat mbizotërojnë kundër-argumentet e listuara më sipër.

Opsioni 3 – Hartimi i ligjit të ri për energjinë termike

Ashtu siç mund të kuptohet nga emërtimi, esenca e këtij opsioni konsiston në planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve të nevojshme institucionale të cilat do të rezultojnë në draftimin dhe miratimin e ligjit të ri për energjinë termike. Qëllimi final është hartimi i një baze ligjore adekuate e cila përkon me zhvillimet e dekadës së fundit në sektorin e energjisë termike si në nivel të BE-së, ashtu edhe brenda Kosovës, dhe e cila është në vijë me zotimin në kuadër të Agjendës së Gjellbër për Ballkanin Perëndimor³³ për rishikimin sipas nevojës të çdo ligji relevant për mbështetjen e dekarbonizimit progresiv të sektorit të energjisë. Në këtë mënyrë jo vetëm që do të krijohet baza e nevojshme ligjore për arritjen e caqeve strategjike në këtë sektor, por njëkohësisht do të mund të bëhet promovimi i mëtejshmë i përmirësimit të Eficiencës së Energjisë (EE), dhe integritetit më të madh të BRE-ve, në sektorin e ndërtesave rezidenciale dhe komerciale. Për më tepër, nëpërmjet hartimit të një ligji të ri, modern dhe gjithëpërfshirës për sektorin e energjisë termike, do të krijohet

³³<https://www.rcc.int/download/docs/Leaders%20Declaration%20on%20the%20Green%20Agenda%20for%20the%20WB.pdf/196c92cf0534f629d43c460079809b20.pdf>

një bazë solide ligjore e integruar në një dokument të vetëm, e cila do të ishte në funksion të realizimit të skemave të renovimit të ndërtesave private dhe publike, dhe e cila do të kontribuonte edhe në uljen e varfërisë energjetike. Disa nga aspektet konkrete të cilat do të adresoheshin, nëpërmjet ligjit të ri për energjinë termike janë si vijon:

- Përafrimi i legjislacionit vendor me atë të BE-së, që konsiston në transpozimin e aspekteve relevante, aktualisht jo të adresuara, siç janë:
 - Mënyrën e përcaktimit të kostos së ngrohjes dhe ftohjes të ndërtesat me shumë apartamente ose ndërtesat me destinacion të shumëfishte;
 - Mënyra e matjes së energjisë së konsumuar për ngrohjen e ujit sanitar në këto ndërtesa;
 - Përcaktimi i periudhës së instalimit të njehsorëve inteligjent;
 - Adresimi i sasive minimale të energjisë nga BRE-të, për ndërtesat e reja dhe ato që i nënshtrohen ndonjë renovimi substancial.
- Planifikimi me kohë i ngrohjes së ujit sanitar;
- Kontributi i autoriteteve lokale për integrimin dhe zgjerimin e përdorimit të BRE-ve, si dhe për planifikimin e infrastrukturës lidhur me ngrohjen/ftohjen qendrore;
- Adresimi i procedurave të koncensionimit në funksion të ofrimit të energjisë termike nga kompani private;
- Adresimi i përgjegjësisë dhe procedurave të shpronësimit dhe servitutit;
- Qartësimi i shërbimeve energjetike dhe subjekteve të cilat mund të ofrojnë shërbime të tilla;
- Përcaktimi i qartë i kufirit ndarës ndërmjet instalimit të brendshëm dhe instalimit nënmenaxhimit të kompanisë së ngrohjes;
- Qartësimi i përgjegjësisë për instalimin e pajisjeve për shpërndarjen dhe matjen e energjisë në pjesën sekondare të ndërtesave komplekse me njësi që funksionojnë mënyrë të pavarur;
- Mënyra e menaxhimit dhe raportimit të ndërhyrjeve/ modifikimeve në instalimin e brendshëm;
- Adresimi i mënyrës së mirëmbajtjes dhe kategorizimin e mirëmbajtjes së rrjetit të brendshëm;
- Përditësimi dhe plotësim i rasteve kur mund të aplikohen masa ndëshkimore ndaj ndërmarrjes që ofron shërbime termike, si dhe adresimi i rasteve kur masa të tilla mund të aplikohen edhe për konsumatorët fundor;
- Specifikimi i akteve nënligjore që duhet të hartohen, institucioneve përgjegjëse dhe afateve kohore për hartimin e tyre.

Natyrisht, në kuadër të ligjit të ri, do të përfshiheshin edhe dispozita të ligjit ekzistues, por të ndryshuara dhe plotësuara në frymën e ndryshimeve të nevojshme të prezantuara më sipër. Në këtë mënyrë, përcaktimi për këtë opsion do të hapte rrugën e hartimit dhe aprovimit të ligjit të ri për energjinë termike. Implementimi dhe integrimi i plotë i ligjit të tillë në kornizën ligjore, përveç përfitimeve të listuara më lartë do të rezultonte edhe në përfitime tjera afatgjate siç janë: ato që kanë të bëjnë me stabilitetin e sistemit energjetik të Kosovës, rritjen ekonomike dhe krijimin e vendeve të reja të punës, rritjen e pavarësisë energjetike, rritjen e konkurrencës brenda sektorit të

energjisë termike, përmirësimin e shëndetit publik, ndikimin pozitiv mjedisor, përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve, përmirësimin e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar, nxitjen e inovacionit teknologjik, rritjen e barazisë sociale dhe gjithëpërfshirëse, si dhe rritjen e përballueshmërisë dhe stabilitetit të kostos lidhur me energjinë termike.

Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme

Në aspektin e veprimeve që do të ndërmerren bazuar në këtë koncept - dokument, institucionet në parim mund të vendosin të përcaktohen për njërin nga opsionet e prezantuara në kapitullin paraprak. Mirëpo, nga përzgjedhja e tillë, do të varen efektet përkatësisht ndikimet të cilat do të reflektohen në kategori të ndryshme e të cilat mund të jenë me karakter ekonomik, shoqëror e mjedisor.

Ndikimet lidhur me Opsionin 1- Ruajtja e Status quos (asnjë ndryshim)

Në rast të përcaktimit të institucioneve për **Opsionin1** (gjë që nuk rekomandohet), atëherë gjendja në sektorin e energjisë termike do të mbetet e pandryshuar. Një gjë e tillë konkretisht do të nënkuptonte që rregullimi i këtij sektori të vazhdoj bazuar në dispozitat e ligjit ekzistues dhe tri (3) ligjeve tjera të ndërlidhura. Rrjedhimisht, në këtë mënyrë nuk do të krijohet mundësia e eliminimit të kufizimeve ekzistuese ligjore, gjë që do të rrezikonte trendin aktual të zhvillimit dhe zgjerimit të shërbimit të ngrohjes, si dhe trendin e uljes së ndotjes mjedisore. Ndikimet përkatëse, varësisht nga kategoria, janë prezantuar në tabelën vijuese.

Tabela 5 : Ndikimet kryesore të identifikuara në rast të përcaktimit për **Opsionin 1**

Kategoritë e ndikimeve	Ndikimet përkatëse të identifikuara
Ndikimet ekonomike	Kosto e lartë për energji termike për konsumatorët familjar, për institucionet dhe ndërmarrjet, cilësi e ultë e shërbimit, zvogëlimi i mundësisë për investime, mungesa e konkurrencës, kufizimi i mundësisë së krijimit të vendeve të reja të punës.
Ndikimet shoqërore	Zvogëlimi i mundësisë për uljen e varfërisë energjetike, rritja e problemeve shëndetësore për shkak të komfortit të munguar termik në hapësirat e banimit, edukimit, të punës dhe shërbimeve, por edhe për shkak të ndotjes lokale të ajrit si rezultat i shfrytëzimit të formave joefiçiente të ngrohjes dhe jomiqësore në raport me mjedisin, si dhe pakënaqësia sociale për shkak të mosofrimit të mundësisë së barabartë për qasje në sistem publik të Ngrohjes Qendrore (NQ).
Ndikimet mjedisore	Do të vazhdoj dëmtimi i ambientit si rezultat i vazhdimit të përdorimit ekstensiv të energjisë elektrike për ngrohjen e hapësirave dhe ujit sanitar, do rrezikohet arritja e objektivave për uljen e emetimeve të Gazeve Serrë (GS), kufizimi i mundësive për integrimin e BRE-ve, dhe teknologjive tjera alternative e miqësore ndaj mjedisit.
Ndikimet në të drejtat themelore	Qasja e kufizuar dhe jo e barabartë në shërbimet e ngrohjes/ftohjes, e drejta e kufizuar për informim të plotë dhe transparent, kufizimi i mundësisë për pjesëmarrje në transformimin e sektorit energjetik.

Ndikimi gjinor	Nuk do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë, megjithatë përcaktimi për këtë opSION do të zvogëlonte mundësinë e krijimit të vendeve të reja të punës, e në këtë mënyrë edhe mundësinë e punësimit të grave.
Ndikimet në barazinë sociale.	Nuk ka ndikim të drejtpërdrejtë.
Ndikimet tek të rinjtë.	Nuk do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë, megjithatë korniza ligjore jo e përditësuar, dhe jo e plotësuar, do të kufizonte mundësitë e investimeve në sektorin e energjisë termike, e në këtë mënyrë edhe në mundësitë e krijimit të vendeve të reja të punës për të rinjtë.
Ndikimet në ngarkesën administrative.	Nuk ka ndikim të drejtpërdrejtë.
Ndikimi të NVM-të.	Ndikimi i drejtpërdrejtë në afarizmin e NVM-ve, për shkak të kostos së lartë së energjisë për ngrohje të hapësirave dhe ujit sanitar nëse të njëjtat nuk ofrohen nga Ngrohja Qendrore (NQ), zvogëlimi i mundësive për investime në modernizimin e shërbimeve, zvogëlimi i mundësive për rritjen kapaciteteve të prodhimit dhe për përmirësimin e cilësisë së produkteve.

Ndikimet lidhur me Opsionin 2

Ky opSION në esencë nënkupton adresimin e mangësive të kornizës ligjore ekzistuese nëpërmjet plotësim/ndryshimit të dispozitave të ligjit ekzistues. Edhe pse në vështrim të parë mund të jetë atraktiv në aspektin e resurseve që duhet angazhuar dhe kohës që duhet investuar për realizimin e plotësim ndryshimeve të nevojshme, përcaktimi për këtë opSION nuk siguron që në këtë mënyrë do krijohet baza e kërkuar dhe e plotë ligjore për rregullimin e sektorit të energjisë termike. Sidomos problematike mund të paraqiten intervenimet e nevojshme nga akterë të ndryshëm, për shkak të ndërlikueshëm kompleks të sektorit të energjisë termike me sektorët tjerë energjetik. Edhe në rastin më të mirë që nënkupton adresimin në tërësi të nevojave aktuale si në raport me direktivat e BE-së, ashtu edhe në raport me nevojat e zbatimit në praktikë dhe perspektivën e zhvillimit të sektorit, baza ligjore e krijuar në këtë mënyrë nuk do të evitonte konfuzionin aktual të dispozitave ligjore të shpërndara nëpër dokumente të shumta. Për pasojë, vështirësitë aktuale në aspektin e përgjegjësisë të implementimit, monitorimit të zbatimit, raportimit dhe planifikimit të zhvillimit të sektorit, nuk dot të adresoheshin në tërësi.

Tabela 6: Ndikimet kryesore të identifikuara në rast të përcaktimit për **Opsionin 2**

Kategoritë e ndikimeve	Ndikimet përkatëse të identifikuara
------------------------	-------------------------------------

Ndikimet ekonomike	Përcaktimi për këtë opsion do të rezultonte në ulje të kostos për konsum të energjisë termike për konsumator dhe ndërmarrje, si rezultat i rritjes së mundësisë për kyçe në rrjetin publik të Ngrohjes Qendrore (NQ), të rritej cilësia dhe siguria e furnizimit të energjisë termike, do të rriteshin mundësitë për investime, do të rritej mundësia e krijimit të vendeve të reja të punës dhe e rritjes së konkurrencës në sektor për shkak të krijimit të mundësive për themelimin e ndërmarrjeve të reja për gjenerimin, shpërndarjen dhe furnizimin me energji termike.
Ndikimet shoqërore	Përmirësimi i bazës ekzistuese ligjore do të reflektohej në uljen e varfërisë, zvogëlimin e problemeve shëndetësore, përmirësimin e kushteve të jetës, edukimit dhe punës, përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe në shkallë më të lartë të kënaqësisë së konsumatorëve me shërbimin e energjisë termike.
Ndikimet mjedisore	Zgjerimi i rrjetit të energjisë termike rezulton në uljen e drejtpërdrejtë të rasteve të përdorimit të energjisë elektrike për ngrohje të hapësirave dhe ngrohje të ujit sanitar. Si rezultat do të ulje ndjeshëm ndotja mjedisore, meqë energjia elektrike në Republikën e Kosovës ende në masën rreth nëntëdhjetë e katër për qind (94 %) prodhohet nga linjiti. Rritja e mundësisë së integritimit më të madh të BRE-ve, dhe teknologjive tjera alternative, do të kishte efekt shtesë në përmirësimin e gjendjes së mjedisit.
Ndikimet në të drejtat themelore	Rritja e barazisë në aspektin e mundësisë për qasje në shërbimin e ngrohjes/ftohjes, përmirësimi i mënyrës së informimit, rritja e transparencës lidhur me shërbimet energjetike dhe krijimi i mundësisë për aktivizimin e qytetarëve lidhur me zhvillimet në sektorit të energjisë termike.
Ndikimi gjinor	Përmirësimi i infrastrukturës ligjore do të ndikonte në zhvillimin e sektorit dhe rritje e mundësive për hapjen e vendeve të reja të punës. Në këtë mënyrë do të rriteshin mundësitë për punësimin e grave, të cilat aktualisht janë pjesë e programeve të ndryshme të aftësimit profesional.
Ndikimet në barazinë sociale	Zhvillimi i sektorit do të rriste mundësinë e qasjes në rrjet dhe në këtë mënyrë do të ofronte mundësinë e pranimin të shërbimit të ngrohjes edhe për shtresat me mundësi të kufizuara financiare. Në këtë mënyrë do të rritej barazia sociale dhe do të ulje varfëria energjetike.
Ndikimet tek të rinjtë	Zgjerimi i kapaciteteve për energji termike dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimeve do të përmirësonte ndjeshëm kushtet e studimeve, si dhe do të rriste krijimin e vendeve të reja të punës, prandaj zhvillimet e tilla do të kishin ndikim të drejtpërdrejtë pozitiv tek gjeneratat e reja.

Ndikimet në ngarkesën administrative.	Ngarkesa administrative mund të rezultojnë nga nevoja për përmirësimin e shërbimeve, si dhe nga procedurat e lidhura me lincensimin e aktiviteteve të ndryshme për ofrimin e energjisë termike dhe të lidhjes së numrit më të madh të konsumatorëve.
Ndikimi të NVM-të.	Zhvillimi i sektorit të energjisë termike do të reflektohet pozitivisht në uljen e kostos së NVM-ve, për ngrohjen e hapësirave dhe të ujit sanitar e në këtë mënyrë në rritjen e qëndrueshmërisë financiare, të mundësisë për investime, të kapacitete prodhuese, përmirësimin i cilësisë së produkteve, rritjen e konkurrueshmërisë, përmirësimi i shërbimeve dhe rritja e punësimit.

Ndikimet lidhur me Opsionin 3 - Hartimi i ligjit të ri për energjinë termike

Përcaktimi për këtë opion nënkupton përcaktimin e institucioneve që të hartojnë bazën ligjore primare të konsoliduar dhe në vijë me të gjitha trendët aktuale të zhvillimit në sektorin e energjisë termike në nivel të BE-së, por edhe në nivel vendi. Në këtë mënyrë, do të krijohet mundësia për përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit të Republikës së Kosovës me atë të BE-së, do të sigurohet korniza rregulluese e aktiviteteve drejt arritjes së objektivave strategjike, si dhe do të shtrihet rruga për vendosjen e caqeve të reja më premtuese, do të promovoheshin fuqishëm planet zhvillimore për zgjerimin e kapaciteteve kogjeneruese dhe për ndërtimin e kapaciteteve të reja të mbështetura në shfrytëzimin e BRE-ve, si dhe të teknologjive të reja siç janë: pompat termike dhe sistemet e shfrytëzimit të energjisë termike të humbur nga proceset tjera teknologjike. Po ashtu, nëpërmjet bazës së re ligjore do të promovohet ngrohja më ekstensive e ujit sanitar nëpërmjet rrjetit të Ngrohjes Qendrore (NQ), e po ashtu për herë të parë do të promovoheshin zhvillimet inovative të ofrimit të ftohjes po ashtu nëpërmjet sistemeve termike qendrore. Në këtë mënyrë do të trasohej rruga për ngritjen e kapaciteteve të reja gjeneruese, do të sigurohet përfshirja më domethënëse e autoriteteve lokale dhe qytetarëve në zhvillimin e sektorit, do të përmirësohet cilësia e shërbimeve, transparenca dhe llogaridhënia e instancave përkatëse të përfshira në zbatimin dhe monitorimin e ligjit. Ligji i ri në përgjithësi do të ofronte bazën e nevojshme ligjore në sektorin e energjisë termike, jo vetëm për zhvillimin dhe transformimin e këtij sektori, por edhe për rritjen e qëndrueshmërisë së përgjithshme energjetike të vendit, si dhe për zvogëlimin domethënës të emetimit të Gazeve Serrë (GS), përfshirë këtu edhe zvogëlimin e problemeve të lidhura me ndotjen lokale të ajrit.

Tabela 7: Ndikimet kryesore të identifikuar në rast të përcaktimit për **Opsionin 3**

Kategoritë e ndikimeve	Ndikimet përkatëse të identifikuar
Ndikimet ekonomike	Ndikimi pozitiv do të rezultonte nga qartësia e dispozitave përkatësisht lehtësimi i zbatimit në llogari të zhvillimit të bizneseve, promovim më të lehtë të teknologjive dhe praktikave që nxisin investimet, mundësia e aprovimit më të lehtë të politikave efikase ekonomike, krijimi i një klime më të favorshme të biznesit, si dhe tërheqja më e lehtë e investimeve vendore dhe atyre të huaja, si dhe

	nga mundësia e rritjes së aftësive konkurruese të bizneseve në tregun vendor dhe atë global.
Ndikimet shoqërore	Përveç uljes së varfërisë, zvogëlimit të problemeve shëndetësore, përmirësimit të kushteve të jetës, edukimit dhe punës, përmirësimit të cilësisë së ajrit dhe rritjes së kënaqësisë së konsumatorëve me shërbimin e energjisë termike, aprovimi i ligjit të ri do të manifestohej pozitivisht edhe në përfshirje më të madhe të niveleve lokale, rajonale dhe qendrore të organizimit shoqëror, do të forconte qëndrueshmërinë e komuniteteve, si dhe do të nxiste partneritetin ndërmjet institucioneve, sektorit privat dhe OJQ-ve.
Ndikimet mjedisore	Krijimi i bazës së re ligjore, ofron mundësinë e vendosjes së standardeve më të larta në aspektin e mbrojtjes së mjedisit, mundësinë e adresimit specifik të mbrojtjes së ekosistemit nga emetimet që rezultojnë nga prodhimi i energjisë termike, inkurajimit të praktikave të ekonomisë qarkulluese, si dhe vendosjen e mekanizmave të qartë të monitorimit dhe raportimit lidhur me mbrojtjen e mjedisit.
Ndikimet në të drejtat themelore	Nëpërmjet aprovimit të ligjit të ri, mund të parashihen dispozitat eksplicite për njohjen dhe mbrojtjen e të drejtave themelore lidhur me qasjen e barabartë në furnizimin me energji termike të qëndrueshme dhe të përballeshme, adresimin korrekt të pabarazive të mundshme, trajtimin korrekt të grupeve të marginalizuara të shoqërisë, promovimin e konsensusit brenda grupeve shoqërore, dhe përfshirjen më aktive të niveleve të ndryshme shoqërore në diskutimin dhe hartimin e politikave të energjisë termike.
Ndikimi gjinor	Baza e re ligjore do të mundësonte trajtimin specifik të barazisë gjinore në sektorin e energjisë termike, provimin e përfshirjes aktive të grave në vendimmarrje, punësim dhe ndërmarrësi, promovimin e zhvillimit të teknologjive në funksion të barazisë gjinore, si dhe mbështetjen e programeve të trajnimit lidhur me barazinë gjinore në sektorin e energjisë termike.
Ndikimet në barazinë sociale	Rritja e mundësisë për trajtimin më specifik të objektivave të barazisë sociale, me qëllim të adresimit të pabarazisë në qasje dhe përballeshmërinë e shërbimit, dëgjimin e zërit të komuniteteve të marginalizuara në procesin e vendimmarrjes, si dhe për adresimin e nevojës lidhur me mbështetjen e ekonomive familjare të cenueshme.
Ndikimet tek të rinjtë	Korniza e re ligjore mund të ndikoj në promovimin në mënyrë efektive teknologjitë dhe zgjidhjet inovative lidhur me energjinë termike, me qëllim të aktivizimit të nismave sipërmarrëse tek të rinjtë, rritjen e mundësive për vende të reja të punës në sferën e BRE-ve, kërkimit dhe zhvillimit, zhvillimin e iniciativave të reja për edukim

	dhe trajnim profesional, si dhe nxitjen e pjesëmarrjes aktive të të rinjve në zhvillimet lidhur dhe brenda sektorit të energjisë termike.
Ndikimet në ngarkesën administrative.	Në kontekstin e ngarkesave të zakonshme administrative të cilat rezultojnë nga nevoja për përmirësimin e shërbimeve, si dhe nga procedurat e lidhura me licencimin e aktiviteteve të ndryshme për ofrimin e energjisë termike dhe të lidhjes së numrit më të madh të konsumatorëve, nëpërmjet bazës së re ligjore mund të parashihen dispozita fleksibile të taksimit dhe lehtësira administrative për nxitjen e zhvillimit të sektorit të energjisë termike.
Ndikimi të Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM).	Krahas ndikimeve të diskutuara lidhur me opsionin paraprak, hartimi i ligjit të ri do të adresonte edhe mundësinë e krijimit të mekanizmave lehtësuese për NVM-të, inkurajimin e tyre për aplikimin e zgjidhjeve inovative lidhur me energjinë termike, duke ju ndihmuar të jenë konkurrent dhe të qëndrueshëm, përfshirjen e NVM-ve, në nivelin lokal për ofrimin e shërbimeve energjetike dhe mbështetjen e partneritetit ndërmjet NVM, agjencive qeveritare dhe kompanive publike.

Mbledhja e të dhënave

Të dhënat e përdorura për hartimin e këtij koncept- dokumenti kanë karakter të informatave ligjore, rregullative, profesionale dhe statistikore të cilat janë pjesë e dokumentacionit publik të ministrive të përfshira, agjencive përkatëse, si dhe Ndërmarrjeve Publike (NP) që ofrojnë shërbime të energjisë termike. Për nevojat e vlerësimit të kërkesave dhe gjendjes lidhur me energjinë termike në nivel të BE-së, janë grumbulluar informata nga dokumente të ndryshme ligjore dhe studime përkatëse, të qasshme publikisht në ueb adresat përkatëse, ndërsa informatat e tilla janë plotësuar edhe me të dhëna nga burimet publike të vendeve të rajonit. Mbledhja e materialeve përkatëse, në funksion të këtij koncept -dokumenti, është mbështetur edhe nga anëtarët e Grupit Punues (GP).

Kapitulli 5: Komunikimi dhe konsultimi

Procesi i komunikimit dhe konsultimit për nevoja të hartimit të këtij koncept-dokumenti është realizuar në nivele të komunikimit me zyrtarët kryesor përgjegjës në Ministrinë e Ekonomisë (ME), zyrtarët përgjegjës të institucioneve tjera shtetërore të nivelit qendror dhe lokal, në nivel të kompanive për ofrimin e shërbimeve energjetike në sektorin e energjisë termike dhe në nivel të konsultave me ekspertë të palinjtë.

Në fazën e hartimit të draftit të koncept - dokumentit, komunikimi dhe konsultimi përkatës është zhvilluar qoftë në kuadër të takimeve të drejtpërdrejta në Grupin Punues (GP), qoftë nëpërmjet takimeve në zyrat përkatëse. Krahas konsultimit dhe komunikimit të Ministrisë së Ekonomisë (ME), me institucionet tjera shtetërore, në kuadër të konsultimit publik, është dhënë mundësia që në proces të përfshihen edhe akterë tjerë relevant për sektorin e energjisë termike, siç janë:

- Shoqëria Civile (ShC);
- Agjencia për Mbrojtjen e Konsumatorëve (AMK);
- Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) përfshirë Odat tjera për mbrojtje të interesave të bizneseve;
- Shoqatat për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë (BRE) dhe Efiçencës së Energjisë (EE);
- Agjencia për Mbrojtje të Mjedisit (AMM);
- Industria – kompanitë e përfshira në aktivitete të mëdha;
- NMV-të;
- Shoqatat e industrisë;
- Institucionet akademike;
- Donatorët;
- Mediat;
- Të tjerë.

Një përmbledhje e komunikimeve dhe konsultimeve të zhvilluara gjatë hartimit të këtij koncept-dokumenti është prezantuar në tabelën vijuese.

Tabela 8: Përmbledhja e aktiviteteve të komunikimit dhe konsultimit të kryera (Kjo pjesë plotësohet pas fazës së Konsultimeve paraprake dhe Publike)

Qëllimi kryesor	Grupi i synuar	Aktiviteti	Komunikimi/njoftimi	Afati tregues	Buxheti i nevojshëm	Personi përgjegjës

--	--	--	--	--	--	--

Kapitulli 6: Krahasoni i opsioneve

Krahasoni i opsioneve të diskutuara në kuadër të këtij koncept - dokumenti mund të bëhet bazuar në kriteret themelore vijuese:

- Niveli i rregullimit të sektorit;
- Shkalla e përputhshmërisë me kornizën ligjore të BE-së;
- Potenciali për promovimin e zhvillimit të sektorit.

Shikuar nga aspekti i kriterëve të tilla, dhe bazuar në diskutimin e prezantuar në seksionin përkatës, mund të thuhet që Opsioni (I)- ruajtja e gjendjes ekzistuese, është opsioni i cili nuk ofron plotësimin adekuat të asnjërit prej tri (3) kriterëve. Kjo arsyetohet me faktin që ky opsion konkretisht do të nënkuptonte vazhdimin e aplikimit të ligjit ekzistues, e në këtë mënyrë, vazhdimin e mosadresimit të çështjeve relevante të cilat kërkohen nga korniza aktuale ligjore në nivel të BE-së. Aq më tepër problematike do të ishte pamundësia e ofrimit të kornizës së nevojshme ligjore në përputhje me potencialin dhe trendet e zhvillimit aktual të këtij sektori. Rrjedhimisht, përcaktimi për këtë opsion do të manifestohej si faktor frenues për zhvillimin dhe modernizimin e sektorit të ngrohjes, si dhe për arritjen e objektivave energjetike dhe mjedisore të vendit. Ndikimet afatgjata do ishin vazhdimi i varësisë së theksuar nga linjiti, kapacitetit të pamjaftueshëm, jo siguri të shërbimit, ndotja e mjedisit dhe mosarritja e objektivave strategjike. Për pasojë do të humbej mundësia e progresit ekonomik nëpërmjet rritjes së stabilitetit të ndërmarrjeve dhe krijimit të vendeve të reja të punës, do të pamundësoheshin investimet e reja në fushën e BRE-ve dhe EE-së, lidhur me energjinë termike, do të vazhdonte pabarazia sociale në aspektin e qasjes në shërbimin e energjisë termike, do vazhdonte ndikimi negativ mjedisor dhe dëmtimi i shëndetit të popullatës.

Opsioni II do të shënonte një lloj progresi lidhur me rregullimin ligjor të sektorit të energjisë termike, por sigurisht nuk do të adresonte në tërësi mangësitë aktuale tashmë të shtjelluara në kuadër të këtij dokumenti. Nevoja për ndërveprimin aktiv të institucioneve të ndryshme dhe numri relativisht i madh i dispozitave që duhet plotësuar/ndryshuar, si dhe dispozitave tërësisht të reja që duhet përfshirë janë faktor të cilët do të komplikonin dhe vështirësonin dukshëm realizimin me sukses të këtij opsioni. Në anën tjetër, efekti promovues për të cilin ka nevojë sektori i energjisë termike, nuk do të ishte në nivelin adekuat, ndërsa procesi i zbatimit po ashtu vështirë që do të ishte efikas, për shkak të vazhimit të trajtimit të aspekteve të ndryshme brenda dokumenteve ligjore të ndryshme, për zbatimin dhe monitorimin e të cilave përgjegjëse janë instanca të ndryshme qeverisëse. Në këtë mënyrë, edhe nëpërmjet opsioni II nuk do të kishte mundësi të arrihej niveli i synuar i zhvillimit të sektorit të energjisë termike, gjë që do të reflektohej po ashtu edhe në një progres të moderuar në aspektin e përmirësimit të Eficiencës së Energjisë (EE), përfshirjes më të madhe të BRE-ve, cilësisë së shërbimit të ofruar dhe zbutjes së ndikimit negativ në mjedis. Një gjë e tillë në aspektin afatgjatë do të kufizonte mundësinë e progresit ekonomik, tërheqjes së investimeve të jashtme, rritjes së siguri të furnizimit, përmirësimit të shëndetit publik, barazisë sociale, dhe kënaqësisë së qytetarëve.

Opsioni III i cili nënkupton draftimin dhe hartimin e ligjit të ri për energjinë termike është opsioni i rekomanduar nga Grupi Punues (GP). Kjo për faktin që vet procesi i hartimit do kishte përparësitë e veta në kuptimin përgjegjësisë bartëse për realizimin e procesit dhe në fleksibilitetin e përfshirjes së gjitha aspekteve për të cilat ka nevojë sektori dhe të cilat do të siguronin pajtueshmërinë e plotë me kornizën përkatëse të BE-së. Në këtë mënyrë do të sigurohej një bazë ligjore moderne, e qëndrueshme dhe mbështetëse e zhvillimeve dhe planeve aktuale, por po ashtu edhe promovuese në aspektin e planeve të reja investive. Ligji i ri, i hartuar me kujdes dhe në vijë me trendet aktuale që karakterizojnë këtë sektor në nivel të BE-së, do të shërbente si katalizator efikas i përmirësimit të mëtejshëm të Eficiencës së Energjisë (EE), sidomos në sektorin e ngrohjes dhe në diversifikimin e burimeve energjetike të këtij sektori. Baza e re ligjore, do të eliminonte paqartësitë dhe situatat e padefinuara ndërmjet konsumatorëve dhe kompanive të ngrohjes, gjë që do të krijonte mundësi për ofrimin e shërbimeve më të mira, si dhe për zgjerimin e kapaciteteve furnizuese. Një zhvillim i tillë i sektorit në aspektin afatgjatë do të reflektehej pozitivisht jo vetëm në kontekstin social e mjedisor (ulja e varfërisë energjetike, zvogëlimi i problemeve shëndetësore dhe zvogëlimi i varësisë nga linjiti përkatësisht zvogëlimi i ndotjes së mjedisit), por efekti do të vërehej edhe në kontekstin e progresit më të madh ekonomik (rritja e rentabilitetit të NVM-ve, dhe krijimi i vendeve të reja të punës), nëpërmjet promovimit së konkurrencës, rritjes së bashkëpunimit ndërkombëtar dhe tërheqjes së investimeve të huaja.

6.1. Tabela e krahasimit me të tre (3) opsionet

Me qëllim të krijimit të mundësisë së krahasimit më të lehtë dhe vlerësimit të përparësive/mangësive reciproke të opsioneve të shtjelluara, në vazhdim është prezantuar tabela krahasuese përkatëse.

Tabela 9: Krahasimi i opsioneve

Aspektet e krahasimit	Opsionet e krahasuara		
	Opsioni 1: Asnjë ndryshim	Opsioni 2: Plotësim/ndryshimi (amandamentimi) i legjislacionit ekzistues	Opsioni 3: Hartimi i akteve të reja ligjore
Ndikimet relevante pozitive			
Rregullimi ligjor i sektori të energjisë termike.	Jo	Pjesërisht	Plotësisht
Zbatim më lehtë dhe monitorim /raportim efikas	Jo	Jo	Po

Promovimi i investimeve në sektor.	Jo			Pjesërisht			Plotësisht		
Diversifikimi i burimeve energjetike dhe promovimi i BRE-ve, në sektor.	Jo			Pjesërisht			Plotësisht		
Harmonizimi me Acquis të BE-së	Jo			Pjesërisht			Plotësisht		
Ndikimet relevante negative	Rregullimi jo adekuat i sektorit, mungesa e promovimit të EE-së dhe BRE-ve, brenda sektorit, mungesa e diversifikimit të burimeve energjetike dhe harmonizimi jo i plotë me politikat e BE-së.			Zbatimi i plotë vështirë i realizueshëm, pamundësia e adresimit të të gjitha zbrazëtirave ligjore, promovimi jo adekuat i EE-së dhe BRE-ve.			Nuk ka		
Kosto	Nuk ka			Kosto e lidhur me zbatimin e dispozitave të plotësuara/ndryshuara			Kosto e lidhur me hartimin e akteve të reja nënligjore dhe me zbatimin e ligjit të ri.		
Rezultate të paqëndrueshme.									
Kostot relevante									
Vlerësimi i ndikimit të pritshëm buxhetor	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 1	Viti 2	Viti 3
Përfundimi									

6.2. Plani i zbatimit për opsionin e rekomanduar

Në vazhdim është paraqitur draft plani i zbatimit për opsionin e rekomanduar nga Grupi Punues (GP), pra për opsionin 3.

Tabela 10: Plani i zbatimit për Opsionin 3 (opsionin e rekomanduar)

Qëllimi i politikës	Përmirësimi domethënës i Efiçencës së Energjisë (EE), rritja e sigurisë së furnizimit dhe zvogëlimi i ndotjes mjedisore në sektorin e ndërtesave rezidenciale dhe terciare.							Shifra e kostonë së pritëur
Objektivi strategjik	Përditësimi dhe konsolidimi i kuadrit ligjor për energjinë termike në përputhje me nevojat aktuale dhe projeksionet zhvillimore të sektorit, në vijë me direktivat e BE-së, dhe standardet ndërkombëtare, dhe në funksion të zgjerimit të kapaciteteve dhe diversifikimit të burimeve ekzistuese.							
	Rezultatet, aktivitetet, viti dhe organizata / departamenti përgjegjës							
Objektivi Specifik 1 Hartimi i ligjit të ri për energjinë termike.	Produkti 1.1							
			Viti 1 2025	Viti 2 2026	Viti 3 2027	Viti 4 2028	Viti 5 2029	Institucioni /departamenti përgjegjës
		<u>Aktiviteti 1.1.1</u> Hartimi i draftit të ligjit të ri për energjinë termike.	X					Ministria e Ekonomisë (ME)
		<u>Aktiviteti 1.1.2</u> Konsultimi publik dhe adresimi i komenteve nga të gjitha palët.	X					Ministria e Ekonomisë (ME)

		<u>Aktiviteti 1.1.3</u> Miratimi i ligjit të ri për energjinë termike nga Qeveria e Republikës së Kosovës (QRK)	X					Qeveria e Republikës së Kosovës (QRK)	Nuk ka kosto shtesë
		<u>Aktiviteti 1.1.4</u> Miratimi i ligjit të ri për energjinë termike nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.	X					Kuvendi i Republikës së Kosovës.	Nuk ka kosto shtesë
		<u>Aktiviteti 1.1.5</u> Informimi i palëve të interesit për ligjin e ri përmes platformave të komunikimit.	X					Ministria e Ekonomisë (ME)	Nuk ka kosto shtesë
	Produkti 1.2	Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore në përputhje me ligjin e ri për energjinë termike.							

			Viti 1 2025	Viti 2 2026	Viti 3 2027	Viti 4 2028	Viti 5 2029	Institucioni /departame nti përgjegjës	
		Aktiviteti 1.2.1 Hartimi i akteve nënligjor e		X	X			ZKM, ME, ZRRrE	
Objektivi Specifik 2: Dyfishimi i kapacitetit ekzistues të kogjenerimi t, si dhe ngritjen e kapaciteteve të reja të kogjenerimi t nëpër komuna në të cilat ekzistojnë mundësit tekniko- ekonomike të realizimit.	Produkti 2.1	Dyfishimi i kapaciteteve kogjeneruese të ndërmarrjeve Termokos/KEK							Është në realizim e sipër nga Termoko si
				X	X			Ministria e Ekonomisë (ME), Termokosi	
	Produkti 2.2	Ndërtimi i kapaciteteve të reja të kogjenerimit							Kosto për realizim të sistemeve të reja të kogjeneri mit nëpër komuna
				X	X	X	X		

Kapitulli 7: Konkluzionet dhe hapat e ardhshëm

7.1. Sfidat aktuale, opsioni optimal dhe rezultatet e pritshme

Planifikimi strategjik lidhur me sektorin e energjisë termike të cilat përfshijnë zgjerimin e kapaciteteve ekzistuese të kogjenerimit, përfshirjen e BRE-ve, si burime energjetike në sektorin e energjisë termike, si dhe ngritjen e kapaciteteve të reja bazuar në studimet përkatëse të fizibilitetit, imponojnë nevojën e përditësimit dhe kompletimit të bazës ligjore përkatëse. Baza aktuale ligjore e përbërë nga ligji për energjinë termike i vitit 2015 dhe një seri aktesh përkatëse nënligjore, nuk i përgjigjet nevojave aktuale dhe dinamikës së paraparë për zhvillimin e këtij sektori. Për pasojë, gjendja aktuale karakterizohet me sfida të shumta për funksionimin e mirëfilltë të kompanive përkatëse që ofrojnë shërbimin e energjisë termike e që manifestohet në shërbime të kufizuara për nga cilësia por edhe për nga përmasat e tyre. Në anën tjetër, konsumi i lartë i energjisë elektrike për mbulimin e nevojave të mëdha për energji termike gjatë dimrit, vazhdon të rëndojë gjendjen e furnizimit stabil me energji elektrike gjë që imponon nevojën imediate për përmirësimin e Efiçencës së Energjisë (EE), në këtë sektor. Forma më praktike dhe e dëshmuar në këtë aspekt është zhvillimi i kapaciteteve të kogjenerimit për çka nevojitet një bashkëpunim më aktiv dhe konkret i autoriteteve lokale me qëllim të ndërtimit të kapaciteteve të tilla brenda territorit të tyre dhe në këtë mënyrë përmirësimit të Efiçencës së Energjisë (EE), në nivel vendi. Zhvillimi i sektorit të energjisë termike përpos përmirësimit të cilësisë së shërbimit do të ndikonte edhe në uljen e varfërisë energjetike, përmirësimin e kushteve për NVM-të, dhe rritjen e afarizmit të tyre, krijimin e vendeve të reja të punës dhe zvogëlimin e problemeve të lidhura me ndotjen mjedisore. Natyrisht, krijimi i bazës së re ligjore do të reflektohej pozitivisht edhe në aspektin e progresit të vendit drejt BE-së, përkatësisht përafrimit të mëtutjeshëm të kornizës aktuale ligjore me kornizën ligjore të BE-së. Rrjedhimisht Grupi Punues (GP) ka analizuar tri (3) opsione të mundshme për adresimin e sfidave të përshkruara brenda këtij dokumenti, dhe bazuar në analizën e tillë ka arritur në përfundim që opsioni më i mirë do të ishte opsioni i cili nënkupton draftimin dhe miratimin e ligjit të ri për energjinë termike opsioni tre (3) dhe akteve përkatëse nënligjore. Përkrahja e këtij opsioni dhe zbatimi i tij do të rezultonte në një bazë ligjore moderne, të kompletuar dhe në vijë me parimet e BE-së, lidhur me sektorin e energjisë termike. Për më tepër ligji i ri do të nxiste investimet përkatëse dhe do të siguronte një bazë të qëndrueshme për zhvillimin e këtij sektori e që do të reflektohej në furnizim stabil me energji, progres ekonomik dhe mirëqenie të qytetarëve. Zhvillimet e tilla do të ishin në harmoni të plotë me obligimet e vendit në raport me Komunitetin e Energjisë (KE), dhe me Agjendën e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor, gjë që do të siguronte një rrugëtim korrekt të vendit drejt tranzicionit energjetik dhe ekonomisë neutrale në raport me emetimet e Gazeve Serrë (GS).

7.2. Dispozitat për monitorimin dhe vlerësimin

Në parim, si për çdo sektor tjetër, edhe në sektorin e energjisë termike monitorimi është një proces thelbësor për zbatimin me efikasitet të politikave që rregullojnë këtë sektor. Sa më e qëndrueshme dhe e kompletuar të jetë baza ligjore aq më i lehtë do të jetë procesi i monitorimit dhe vlerësimit përkatës lidhur me zbatimin e saj. Rrjedhimisht, një prej objektivave të krijimit të bazës së re ligjore është edhe përmirësimi i mekanizmave të monitorimit nëpërmjet krijimit të një baze ligjore

kompakte dhe evitimit të konfuzionit si rezultat i trajtimit të aspekteve të ndryshme të energjisë termike nëpër dokumente tjera të shumta. Po ashtu edhe vet vendimi përkatës i cili rezulton nga ky koncept - dokument duhet të monitorohet nga aspekti i nivelit të zbatimit. Disa nga caqet kryesore indikative që do të përdoren gjatë monitorimit dhe vlerësimit të këtij koncepti -dokumenti janë:

- Zbatimi i politikave dhe kërkesave ligjore;
- Nevoja për trajnim dhe/ose për personel shtesë;
- Ndikimet socio-ekonomike;
- Ndikimet mjedisore;
- Konsultimet ndërinstytucionale dhe publike;
- Komunikimi i ndryshimeve të mundshme me audiencën e synuar, etj.

Shtojca 1: Forma e vlerësimit për ndikimin ekonomik

Kategoria e ndikimeve ekonomike	Ndikimi kryesor	A pritët të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur	Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo	I lartë/i ulët	I lartë/i ulët	
Vendet e punës ³⁴	A do të rritet numri aktual i vendeve të punës?	Po		Lartë	Lartë	
	A do të zvogëlohet numri aktual i vendeve të punës?		Jo	Ulët	Ulët	
	A do të ndikojë në nivelin e pagesës?	Po		Lartë	Lartë	
	A do të ndikojë në lehtësimin e gjetjes së një vendi të punës?	Po		Lartë	Lartë	
Bërja e biznesit	A do të ndikojë në qasjen në financa për biznes?	Po		Lartë	Lartë	
	A do të largohen nga tregu produkte të caktuara?		Jo	Ulët	Ulët	Megjithatë, do të eliminohen teknologjitë joefiçiente për energjinë termike.
	A do të lejohen në treg produkte të caktuara?	Po		Lartë	Lartë	Do të promovohen produktet efikase dhe teknologjitë alternative për energjinë termike.

³⁴ Kur ndikon vendet e punës, do të ketë edhe ndikime sociale.

	A do të detyrohen bizneset të mbyllen?		Jo	Ulët	Ulët	
	A do të krijohen biznese të reja?	Po		Lartë	Lartë	
Ngarkesa administrative	A do të detyrohen bizneset t'i përmbushin detyrimet e dhënies së informatave të reja?	Po		Lartë	Lartë	
	A janë thjeshtuar detyrimet e dhënies së informatave për bizneset?	Jo		Ulët	Ulët	
Tregtia	A pritet të ndryshojnë flukset aktuale të importit?	Po		Lartë	Lartë	
	A pritet të ndryshojnë flukset aktuale të eksportit?	Jo		Ulët	Ulët	
Transporti	A do të ketë efekt në mënyrën e transportit të pasagjerëve dhe/ose mallrave?	N/A				
	A do të ketë ndonjë ndryshim në kohën e nevojshme për të transportuar pasagjerë dhe/ose mallra?	N/A				
Investimet	A pritet që kompanitë të investojnë në veprimtari të reja?	Po		Lartë	Lartë	
	A pritet që kompanitë t'i anulojnë ose shtyjnë për më vonë investimet?		Jo	Ulët	Ulët	
	A do të rriten investimet nga diaspora?	Po		Lartë	Lartë	

	A do të zvogëlohen investimet nga diaspora?		Jo	Ulët	Ulët	
	A do të rriten investimet e huaja direkte?	Po		Lartë	Lartë	
	A do të zvogëlohen investimet e huaja direkte?		Jo	Ulët	Ulët	
Konkurrueshmëria	A do të rritet çmimi i biznesit të produkteve, siç është energjia elektrike?		Jo	Ulët	Ulët	
	A do të ulët çmimi i inputeve të bizneseve, siç është energjia elektrike?		Jo	Ulët	Ulët	
	A ka gjasa që të promovohen inovacioni dhe hulumtimi?	Po		Lartë	Lartë	
	A ka gjasa që inovacioni dhe hulumtimi të pengohen?		Jo	Ulët	Ulët	
Ndikimi në NVM-të	A janë kompanitë e prekura kryesisht NVM-të?	Po		Lartë	Lartë	
Çmimet dhe konkurrenca.	A do të rritet numri i mallrave dhe shërbimeve në dispozicion për biznesin apo konsumatorët?	Po		Lartë	Lartë	
	A do të zvogëlohet numri i mallrave dhe shërbimeve në dispozicion për biznesin apo konsumatorët?		Jo	Ulët	Ulët	

	A do të rriten çmimet e mallrave dhe shërbimeve ekzistuese?		Jo	Ulët	Ulët	
	A do të ulen çmimet e mallrave dhe shërbimeve ekzistuese?		Jo	Ulët	Ulët	
Ndikimet ekonomike rajonale.	A do të ndikohet ndonjë sektor i veçantë i biznesit?	Po		Lartë	Lartë	
	A është ky sektor i koncentruar në një rajon të caktuar?		Jo	Lartë	Lartë	Organizatat/individët që do të përfitojnë shtrihen në tërë Republikën e Kosovës dhe ndikimi do të jetë i lartë.
Zhvillimi i përgjithshëm ekonomik.	A do të ndikohet rritja e ardhshme ekonomike?	Po		Lartë	Lartë	
	A mund të ketë ndonjë efekt në normën e inflacionit?		Jo	Ulët	Ulët	

Shtojca 2: Forma e vlerësimit për ndikimet shoqërore

Kategoria e ndikimeve shoqërore	Ndikimi kryesor	A pritët të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur	Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo	I lartë/i ulët	I lartë/i ulët	
Vendet e punës ³⁵	A do të rritet numri aktual i vendeve të punës?	Po		Lartë	Lartë	
	A do të zvogëlohet numri aktual i vendeve të punës?		Jo	Ulët	Ulët	
	A ndikohen vendet e punës në një sektor të caktuar të biznesit?	Po		Lartë	Lartë	
	A do të ketë ndonjë ndikim në nivelin e pagesës?	Po		Lartë	Lartë	
	A do të ketë ndikim në lehtësimin e gjetjes së një vendi të punës?	Po		Lartë	Lartë	
Ndikimet shoqërore rajonale.	A janë ndikimet shoqërore të përqendruara në një rajon apo qytete të veçanta?		Jo	Ulët	Ulët	
Kushtet e punës.	A ndikohen të drejtat e punëtorëve?	Po		Lartë	Lartë	Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve lidhur me energjinë termike ka ndikim në të drejtën e

³⁵ Ndikimi në vendet e punës, reflektohet edhe me ndikime ekonomike.

						punëtorëve për kushte më të mira të punës.
	A parashihen apo shfuqizohen standardet për punën në kushte të rrezikshme?		Jo	Ulët	Ulët	
	A do të ketë ndikim mbi mënyrën e zhvillimit të dialogut social ndërmjet punonjësve dhe punëdhënësve?		Jo	Ulët	Ulët	
Përfshirja sociale.	A do të ketë ndikim mbi varfërinë?	Po		Lartë	Lartë	
	A ndikohet qasja në skemat e mbrojtjes sociale?		Jo	Ulët	Ulët	
	A do të ndryshojë çmimi i mallrave dhe shërbimeve themelore?		Jo	Ulët	Ulët	
	A do të ketë ndikim në financimin apo organizimin e skemave të mbrojtjes sociale?		Jo	Ulët	Ulët	
Arsimi	A do të ketë ndikim në arsimin fillor?		Jo			
	A do të ketë ndikim në arsimin e mesëm?	Po		Lartë	Lartë	Sistemet efiçiente të energjisë termike, dhe miqësore ndaj mjedisit duhet të promovohen në programet shkollore.
	A do të ketë ndikim në arsimin e lartë?	Po		Lartë	Lartë	Sistemet efiçiente të energjisë termike, dhe miqësore ndaj mjedisit

						duhet të promovohen në programet shkollore.
	A do të ketë ndikim në aftësimin profesional?	Po		Lartë	Lartë	Sistemet efikënte të energjisë termike, dhe miqësore ndaj mjedisit duhet të promovohen në programet aftësimit profesional
	A do të ketë ndikim në arsimimin e punëtorëve dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës?	Po		Lartë	Lartë	Sistemet efikënte të energjisë termike, dhe miqësore ndaj mjedisit duhet të promovohen në programet aftësimit të vazhdueshëm
	A do të ketë ndikim në organizimin apo strukturën e sistemit arsimor?	Po		Lartë	Lartë	Sistemet efikënte të energjisë termike, dhe miqësore ndaj mjedisit duhet të promovohen në programet akademike
	A do të ketë ndikim në lirinë akademike dhe vetëqeverisjen?		Jo	Ulët	Ulët	
Kultura	A ndikon opsioni në diversitetin kulturor?	N/A				
	A ndikon opsioni në financimin e organizatave kulturore?	Po		Lartë	Lartë	Rritja e kapaciteteve për energji termike, ul koston e ngrohjes.

	A ndikon opsioni në mundësitë për personat që të përfitojnë nga aktivitetet kulturore ose të marrin pjesë në to?	Po		Lartë	Lartë	Përmirësimi i shërbimit për energji termike, rritë mundësinë për të përfituar.
	A ndikon opsioni në ruajtjen e trashëgimisë kulturore?	N/A				
Qeverisja	A ndikon opsioni në aftësitë e qytetarëve të marrin pjesë në procesin demokratik?	Po		Lartë	Lartë	
	A trajtohet çdo person në mënyrë të barabartë?	Po		Lartë	Lartë	
	A do të informohet më mirë publiku në lidhje me çështje të caktuara?	Po		Lartë	Lartë	
	A ndikon opsioni në mënyrën se si funksionojnë partitë politike?	N/A				
	A do të ketë ndonjë ndikim në shoqërinë civile?	Po		Lartë	Lartë	
Shëndeti dhe siguria publike ³⁶	A do të ketë ndonjë ndikim në jetën e njerëzve, siç është jetëgjatësia apo shkalla e vdekshmërisë?	Po		Lartë	Lartë	
	A do të ketë ndikim në cilësinë e ushqimit?	Po		Lartë	Lartë	

³⁶ Ndikimi në shëndetin është i lidhur me ndikime mjedisore

	A do të rritet apo zvogëlohet rreziku shëndetësor për shkak të substancave të dëmshme?	Po		Lartë	Lartë	Përmirësimi i EE-së, dhe përdorimi i BRE-ve, ul rrezikun shëndetësor.
	A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në nivelet e zhurmës apo cilësinë e ajrit, ujit dhe/ose tokës?	Po		Lartë	Lartë	
	A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në përdorimin e energjisë?	Po		Lartë	Lartë	
	A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në deponimin e mbeturinave?	Po		Lartë	Lartë	
	A do të ketë ndikim në mënyrën e jetesës së njerëzve, siç janë: nivelet e interesimit për sport, ndryshimet në ushqyeshmëri, ose ndryshimet në përdorimin e duhanit ose alkoolit?	Po		Lartë	Lartë	
	A ka grupe të veçanta që përballen me rreziqe shumë më të larta se të tjerat (të përcaktuar sipas faktorëve, të tillë si: mosha, gjinia, aftësia e kufizuar, grup shoqëror apo rajoni)?	Jo		Ulët	Ulët	Rritja e mundësisë për qasje në energjinë termike nuk ndikon negativisht në asnjë grup të veçantë.
Krimi dhe siguria	A ndikohen gjasat që të kapen kriminelët?	N/A				

	A ndikohet fitimi i mundshëm nga krimi?	N/A				
	A ndikon në nivelet e korrupsionit?	N/A				
	A ndikohet kapaciteti i zbatimit të ligjit?	N/A				
	A ka ndonjë efekt në të drejtat dhe sigurinë e viktimave të krimit?	N/A				

Shtojca 3: Forma e vlerësimit për ndikimet mjedisore

Kategoria e ndikimeve mjedisore	Ndikimi kryesor	A pritët të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur	Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo	I lartë/i ulët	I lartë/i ulët	
Klima dhe mjedisi i qëndrueshëm.	A do të ketë ndikim në emetimin e Gazrave Serrë (GS), (dioksid karboni, metani etj.)?	Po		Lartë	Lartë	
	A do të ndikohet konsumi i karburanteve?	Po		Lartë	Lartë	
	A do të ndryshojë shumëllojshmëria e burimeve që përdoren për prodhimin e energjisë?	Po		Lartë	Lartë	
	A do të ketë ndonjë ndryshim në çmim për produktet miqësore ndaj mjedisit?	Po		Lartë	Lartë	Rritja e kërkesës do të ndikojë në uljen e çmimit të produkteve të tilla.
	A do të bëhen më pak ndotëse disa aktivitete të caktuara?	Po		Lartë	Lartë	
Cilësia e ajrit	A do të ketë ndikim në emetimin e ndotësve të ajrit?		Po	Lartë	Lartë	
Cilësia e ujit	A ndikon opsioni në cilësinë e ujërave të ëmbla?		Jo	Ulët	Ulët	

	A ndikon opsioni në cilësinë e ujërave nëntokësore?		Jo	Ulët	Ulët	
	A ndikon opsioni në burimet e ujit të pijshëm?		Jo	Ulët	Ulët	
Cilësia e tokës dhe shfrytëzimi i tokës.	A do të ketë ndikim në cilësinë e tokës (në lidhje me acidifikimin, ndotjen, përdorimin e pesticideve apo herbicideve)?		Jo	Ulët	Ulët	
	A do të ketë ndikim në erozionin e tokës?		Jo	Ulët	Ulët	
	A do të humbet tokë (përmes ndërtimit, etj.)?	Po		Ulët	Ulët	Mund të ketë humbje të kufizuar të hapësirës tokësore nga shtrirja e rrjetit dhe ndërtimi i njësive të reja prodhuese.
	A do të fitohet tokë (përmes dekontaminimit, etj.)?		Jo	Ulët	Ulët	
	A do të ketë ndonjë ndryshim në shfrytëzimin e tokës (p.sh. nga shfrytëzimi pyjor në shfrytëzim bujqësor apo urban)?		Jo	Ulët	Ulët	
Mbeturinat dhe riciklimi.	A do të ndryshojë sasia e mbeturinave të krijuara?	Po		Lartë	Lartë	

	A do të ndryshojnë mënyrat në të cilat trajtohen mbeturinat?	Po		Lartë	Lartë	
	A do të ketë ndikim në mundësitë për riciklimin e mbeturinave?	Po		Lartë	Lartë	
Përdorimi i burimeve.	A ndikon opsioni në përdorimin e burimeve të ripërtëritshme (rezervave të peshkut, hidrocentraleve, energjisë diellore etj.)?		Jo	Ulët	Ulët	Llojet e BRE-ve, që promovohen nuk përfshinë energjinë e ujit.
	A ndikon opsioni në përdorimin e burimeve, të cilat nuk janë të ripërtëritshme (ujërat nëntokësore, mineralet, qymyri etj.)?		Jo	Ulët	Ulët	
Shkalla e rreziqeve mjedisore.	A do të ketë ndonjë efekt në gjasat për rreziqe, të tilla, si zjarret, shpërthimet apo aksidentet?		Jo	Ulët	Ulët	
	A do të ndikojë në gatishmërinë në rast të fatkeqësive natyrore?		Jo	Ulët	Ulët	
	A ndikohet mbrojtja e shoqërisë nga fatkeqësitë natyrore?		Jo	Ulët	Ulët	
Biodiversiteti, flora dhe fauna.	A do të ketë ndikim në speciet e mbrojtura apo të rrezikuara apo në zonat ku ato jetojnë?		Jo	Ulët	Ulët	
	A do të preket madhësia apo lidhjet midis zonave të natyrës?		Jo	Ulët	Ulët	

	A do të ketë ndonjë efekt në numrin e specieve në një zonë të caktuar?		Jo	Ulët	Ulët	
Mirëqenia e kafshëve	A do të ndikohet trajtimi i kafshëve?		Jo	Ulët	Ulët	
	A do të ndikohet shëndeti i kafshëve?		Jo	Ulët	Ulët	
	A do të ndikohet cilësia dhe siguria e ushqimit të kafshëve?		Jo	Ulët	Ulët	

Shtojca 4: Forma e vlerësimit për ndikimin e të drejtave themelore

Kategoria e ndikimit në të drejtat themelore	Ndikimi kryesor	A pritët të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur	Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo	I lartë/i ulët	I lartë/i ulët	
Dinjteti	A ndikon opsioni në dinjtetin e njerëzve, në të drejtën e tyre për jetë apo në integritetin e një personi?		Jo	Ulët	Ulët	
Liria	A ndikon opsioni në të drejtën e lirisë së individëve?		Jo	Ulët	Ulët	
	A ndikon opsioni në të drejtën e një personi për privatësi?		Jo	Ulët	Ulët	
	A ndikon opsioni në të drejtën për t'u martuar apo krijuar familje?		Jo	Ulët	Ulët	
	A ndikon opsioni në mbrojtjen ligjore, ekonomike ose shoqërore të individëve apo familjes?		Jo	Ulët	Ulët	
	A ndikon opsioni në lirinë e mendimit, ndërgjegjes apo fesë?		Jo	Ulët	Ulët	
	A ndikon opsioni në lirinë e shprehjes?		Jo	Ulët	Ulët	
	A ndikon opsioni në lirinë e tubimit ose asociimit?		Jo	Ulët	Ulët	

Të dhënat personale.	A përfshin opsioni përpunimin e të dhënave personale?		Jo	Ulët	Ulët	
	A janë të drejtat e individit për qasje, korrigjim dhe kundërshtim të garantuara?		Jo	Ulët	Ulët	
	A është e qartë dhe e mbrojtur mirë mënyra në të cilën përpunohen të dhënat personale?		Jo	Ulët	Ulët	
Azili	A ndikon ky opsioni në të drejtën për azil?		Jo	Ulët	Ulët	
Të drejtat pronësore.	A do të ndikohen të drejtat e pronësisë?		Jo	Ulët	Ulët	
	A ndikon opsioni në lirinë për të bërë biznes?		Jo	Ulët	Ulët	
Trajtimi i barabartë ³⁷	A e mbron opsioni parimin e barazisë para ligjit?	Po		Ulët	Ulët	
	A ka gjasa që grupe të caktuara do të dëmtohen në mënyrë direkte apo indirekte nga diskriminimi (p.sh. ndonjë diskriminim në bazë gjinore, racore, ngjyre, etnie, opinioni politik ose tjetër, moshe ose orientimi seksual)?		Jo	Ulët	Ulët	

³⁷ Barazia gjinore trajtohet në Vlerësimin e Ndikimit Gjinor

	A ndikon opsioni në të drejtat e personave me aftësi të kufizuara?		Jo	Ulët	Ulët	
Të drejtat e fëmijëve.	A ndikon opsioni në të drejtat e fëmijëve?		Jo	Ulët	Ulët	
Administrimi i mirë.	A do të bëhen procedurat administrative më të komplikuar?		Jo	Ulët	Ulët	
	A ndikohet mënyra në të cilën administrata merr vendime (transparenca, afati procedural, e drejta për qasje në një dosje, etj.)?		Jo	Ulët	Ulët	
	Për të drejtën penale dhe ndëshkimet e parashikuara: a ndikohen të drejtat e të paditurit?		Jo	Ulët	Ulët	
	A ndikohet qasja në drejtësi?		Jo	Ulët	Ulët	